




Plani i Mbrojtjes Sociale
Bashkia Pogradec
2019 - 2023

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr., datë/...../2019



Plani i Kujdesit Social është hartuar nga Bashkia Pogradec në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit “Ndhmë për Fëmijët” në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush Të Mos Mbetet Pas” që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
1. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PKS	5
1.1 Qëllimi dhe objektivat e PKS-së	5
1.2 Parimet e Planit të Kujdesit Social.....	5
1.3 Procesi dhe përmbajtja e PKS-së	6
1.4 Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor.....	7
2. SITUATA SOCIAL EKONOMIKE E BASHKISË POGRADEC	8
2.1 Veçoritë Fizike dhe Mjedisore	9
2.2 Të dhëna demografike	9
2.3 Arsimi.....	11
2.4 Ekonomia në bashkinë Pogradec.....	13
2.5 Punësimi dhe papunsia	13
2.6 Shëndetsia	14
3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, NJERZORE DHE FINANCIARE TË BASHKISË POGRADEC PËR TË OFRUAR SHËRBIME SOCIALE	15
3.1 Shërbimi Social Pogradec.....	15
3.2 Struktura e Drejtorisë së Shërbimit Social Pogradec.....	15
3.3 Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social	16
3.4 Shërbimet ekzistuese të përkuajdesit shoqëror	17
3.5 Zyra e mbështetjes së Nënës dhe Fëmijës	18
3.6 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale	18
3.7 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Pogradec	20
3.8 Shoqatat dhe shërbimet e përkuajdesjes sociale në Bashkinë e Pogradecit	21
3.9 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimarrje të informuar.....	21
4. NEVOJAT PËR SHËRBIME SOCIALE TË GRUPEVE VULNERABËL DHE ATYRE NË RISK	22
4.1 Famijet e varfëra.....	22
4.2 Personat me aftësi të kufizuar.....	23
4.3 Fëmijet në risk.....	24
4.3.1 Fëmijët me aftësi të kufizuara	24
4.3.2 Fëmijet në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë	25
4.4 Të rinjtë me probleme sociale	26
4.4.1 Papunsia tek të rinjtë	26
4.5 Gratë me probleme sociale.....	27
4.6 Familjet e pastreha	27
4.7 Komunitetet.....	28
Analiza SËOT Bashkia Pogradec	30
5. PERCAKTIMI I FUSHAVE, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË PKS-SË	33
ANEKSET	37
Aneksi 1. Plani i veprimit për shërbimet e kujdesit social në bashkinë Pogradec për periudhën 2019-23	37
Aneksi 2. Plani i monitorimit dhe vlerësimit	47

Aneksi 3. Kostimi dhe hendeku buxhetor	49
Aneksi 4. Shporta e shërbimeve shoqerore.....	54

HYRJE

Çështjet sociale janë bërë të rëndësishme dhe prioritare në agjendën e politikave vendore, veçanërisht pas Reformës Administrative Territoriale që u ndërmor në vitin 2014¹. Ndryshimet në numrin e popullsisë për çdo njësi administrative (bashkitë e reja) si dhe zhvillimi i legjislacionit në favor të shtimit të funksioneve dhe kompetencave të pushtetit vendor, kërkon një qasje tjetër në hartimin, zbatimin dhe monitorimin politikave sociale vendore. Politikat vendore të planifikimit të shërbimeve sociale, të ndjekura deri më sot në Shqipëri, nuk arrijnë të mbështesin shpeshtësinë dhe kompleksitetin e problemeve sociale që reflektohen në jetën e një komuniteti. Në këto kushte, është e domosdoshme të zhvillohen qasje bashkëkohore dhe mbi të gjitha “strategjike” me qëllim krijimin e ekuilibrit midis objektivave të zhvillimit territorial të Bashkisë dhe nevojave sociale të individëve, familjeve dhe komunitetit, për vëmendjen e pushtetit vendor dhe të gjithë shoqërisë.

Dokumenti i Planit të Kujdesit Social (PKS) i Bashkisë Pogradec do të shërbejë jo vetëm si pjesë e përfaqësues strategjike për zhvillimin e Bashkisë në tërësi, por edhe si njënevojë për njëqeverisje të mirë dhe demokratike, për të përmbushur përgjegjësinë ndaj qytetarëve për shërbime sociale të përshtatshme. Ky dokument do të jetë baza mbi të cilën do të mbështeten iniciativat e Bashkisë, shoqërisë civile, dhe ofruesve publik dhe privat të shërbimeve sociale, për zgjidhjen e problemeve sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.

Plani i prezantuar në vazhdim është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse i hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për të adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 përcaktohet se: “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtetas në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.”. Gjithashtu në Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 “Roli i Bashkisë” përcaktohet se: “njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore, bashkia harton planin e kujdesit social vendor”.

Plani Kujdesit Social është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e

¹<http://www.reformaterritoriale.al/>

shërbimeve sociale. Ai shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2019-2023) i cili është i ndarë në katër fusha kryesore:

1. Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve
2. Ngritja e kapaciteteve të strukturave dhe burimeve njerëzore;
3. Zhvillimin e shërbimevesociale në Bashkinë e Pogradecit;
4. Programet parandaluese;

1. Metodologjia e hartimit të PKS

1.1 Qëllimi dhe objektivat e PKS-së

Në zbatim të vizionit të saj, Bashkia Pogradec synon të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke siguruar një kohezion social ndërmjet të gjithë grupeve të qytetarëve pavarësisht statusit social të tyre².

Ky vizion, i kthyer në prioritet lokale, përcjell qëllimin dhe një sërë objektiva specifike.

- Bashkia Pogradec do të ndërmarrë nisma që përmirësojnë strukturat administrative të shërbimeve sociale, përfshirë planifikimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë.
- Bashkia Pogradec do të mbështesë fuqizimin e decentralizimit, në funksion të efikasitetit të dhënies së shërbimeve cilësore për qytetarët, familjet dhe komunitetet në nevojë. Ndër të tjera, këtë gjë do ta realizojë duke rritur autonominë financiare dhe modernizuar shërbimet sociale. Bashkia do të marrë rolin e zhvilluesit apo promotorit të ofrimit të shërbimeve në territor.
- Bashkia do të garantojë parimin e barazisë duke u fokusuar veçanërisht tek nevojat me emergjente për shërbime sociale.
- Bashkia do të punojë, për të prezantuar një tërësi instrumentesh në funksion të fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe integritetit të tij në ekonominë vendore dhe në zhvillimin e territorit.

1.2 Parimet e Planit të Kujdesit Social

Bashkia Pogradec, për hartimin dhe përmbushjen e PKS-së në tërësi, dhe veçanërisht qëllimit dhe objektivave të tij, do të mbështetet mbi disa parime kryesore, të cilat mund të klasifikohen si: 1) parime të qeverisjes së mirë; 2) parime të respektimit të të drejtave të njeriut.

Parimi Demokratik: Qeverisja e mirë, rezulton në një planifikim të qëndrueshëm të territorit duke marrë në konsideratë nevojat për shërbime sociale të popullsisë. Është e rëndësishme që vendimet e planifikimit të hartohen dhe të merren me anë të proceseve dhe mekanizmave demokratike siç janë transparenca dhe gjithëpërfshirja. Këto vendime duhet të sigurojnë drejtësinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

²<http://bashkiapogradec.al/document-category/vizion/>

Parimi i gjithëpërfshirjes: Planifikimi i shërbimeve bëhet me përfshirjen e grupeve të interesit, jo vetëm për të qenë sa më afër qytetarëve, por edhe për të siguruar shërbime të përshtatshme, cilësore dhe efçente. Gjithashtu procedurat efektive për përfshirjen e komunitetit do të përmirësojnë legjitimitetin e politikë-bërjes, duke krijuar një ndjenjë të fortë të pronësisë lokale. Procesi i politikë-bërjes duhet të jetë transparent, në mënyrë që të gjithë qytetarët (veçanërisht grupet e interesit) të jenë në dijeni të arsyes së marrjes së vendimit dhe të ndikimit të tij mbi ta.

Parimi i integritit dhe bashkërendimit të politikave: PKS është i përshtatur brenda një kuadri dhe konteksti të planeve ekzistuese të zhvillimit të kësaj bashkie, duke bashkërenduar politikat dhe planet për të pasur një harmonizim sa më të mirë të zhvillimit të territorit. Madje, e gjithë korniza strategjike është e integruar edhe me politikat kombëtare siç është Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020.

Parimi i proporcionalitetit: Gjatë hartimit të PKS-së, është parë e nevojshme që planifikimi të dëshmojë për një angazhim të fortë dhe udhërrëfyes të Qeverisë, në modelet dhe standardet e shërbimeve në formën e politikave të qarta dhe të qëndrueshme. Kjo kontribuon në krijimin e qartësisë dhe redukton rrezikun për të ofruar shërbime jo cilësore. Mirëpo, në të njëjtën kohë, planifikimi i shërbimeve duhet të jetë mjaftueshëm fleksibël, për t'u adaptuar me ndryshimet sociale dhe teknologjike, si dhe për të stimuluar shërbime inovatore. Gjithashtu, Planido të ketë parasysh interesat e palëve, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale dhe të garantojnë konsensus midis grupeve të interesit në favor të grupeve më në nevojë.

Decentralizimi dhe kompetencat e qarta mes institucioneve: Decentralizimi nuk është qëllim në vetvete, por një mjet për të arritur qëllimin më madhor, të garantimit të shërbimeve cilësore dhe efçiente, sa më afër qytetarëve. Mirëfunksionimi i decentralizimit, varet gjerësisht nga përcaktimi i kompetencave të qarta për të dyja nivelet (qendror dhe vendor). Kjo qasje do të eliminojë mungesën e efçienës dhe do të garantojë marrjen e rezultateve. Në kuadër të këtij parimi qëndron dhe nevoja për komunikim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve, në këtë rast bashkisë Pogradec dhe institucioneve të tjera qendrore që veprojnë në territor dhe që lidhen me shërbimet sociale siç janë ato arsimore, shëndetësore, të punësimit etj.

1.3 Procesi dhe përmbajtja e PKS-së

Nisur nga çështjet dhe pyetjet e mësipërme, ky plan do të fokusohet në:

- Një analizë social ekonomike të Bashkisë Pogradecit;
- Vlerësimin e kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të bashkisë, për të ofruar shërbime sociale me standarde;
- Vlerësimin e nevojave sociale, nëpërmjet «inventarizimit» të grupeve në nevojë.
- Evidentimin e modeleve dhe praktikave më të mira të shërbimeve që zhvillohen në territorin e bashkisë
- Hartimin e një Plani Veprimi për periudhën 2019-2023, për Bashkinë e Pogradecit në nivel aktivitetesh dhe buxhetimi i masave të planit.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti zbaton një qasje meta-analitike të kombinuar me një proces me pjesëmarrje. Qasja meta-analitike bën të mundur analizën, sintezën dhe nxjerrjen e përfundimeve nga dokumentet ekzistues, siç janë: plani e zhvillimit të bashkisë, plani buxhetor afatmesme, profili social i bashkive etj.

Gjithashtu metodologjia është bazuar te metoda e vlerësimit me pjesëmarrje, përmes kombinimit të intervistave me aktorët përgjegjës dhe profesionistëve të fushave të: shërbimeve sociale, shëndetësore, arsimit, punësimit dhe formimit profesional, me mbledhjen të dhënave statistikore dhe informacionit të disponueshëm në nivel lokal.

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë bëri të mundur që nëpërmjet grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia Pogradecit. Gjithashtu u zhvilluan konsultime edhe me përfaqësues të organizatave të tjera, të cilat veprojnë në territorin e bashkisë, me fokus ofrimin e shërbimeve sociale për target grupe të ndryshëm. Në mënyrë të hollësishme, përgatitja e këtij raporti ndoqi veprimet si më poshtë:

- Një vështrim i plotë i politikave vendore lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale,
- Një inventar i shërbimeve të ofruara nga organizata dhe shoqata që ofrojnë shërbime sociale në Bashkinë e Pogradecit,
- Të dhënat e Bashkisë Pogradecit për shërbimet sociale dhe kategoritë e targetuara,
- Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale,
- Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor,
- Konsultimet me drejtuesit e projektit dhe koordinatorët,
- Intervistë me përfaqësues të Këshillit Bashkiak,
- Konsultim me përfaqësues të organizatave të tjera që ofrojnë shërbime për komunitetin.

Metodologjia është hartuar duke marrë në konsideratë Bashkinë e Pogradecit si njësi më vete me specifikat e nevojave për shërbime sociale, si dhe me specifikat për zhvillimin e shërbimeve në të ardhmen. Metodologjia ka parashikuar gjithashtu mbledhjen e të dhënave sasiore (aty ku disponohen) për secilin target grup dhe shërbimet sociale që ofrohen.

1.4 Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor

Sfidat me të cilat përballet pushteti vendor pas ndarjes së re administrative janë të shumta, por kryesore mbetet hartimi i politikave për integrimin e grupeve të ndryshme shoqërore në strategjitë e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të bashkisë së re. Shumë zona, për shkak të numrit të vogël të banorëve, rrezikojnë të mbeten të pa përfaqësuara në këshillin bashkiak, çka mund të rrezikojë të përkthehet në mungesë interesi, investimesh dhe shërbimeshpër to. Pothuajse gjysma e zonave që tashmë do të kenë si qendër qytetin liqenor, kanë mungesa të theksuara të infrastrukturës ndërlidhëse me Pogradecin dhe jo rrallë izoloohen nga dëborat gjatë muajve të dimrit, çka identifikohet si një sfidë e mundshme lidhur me marrjen dhe aksesin e shërbimeve që do të ofrohen në nivel bashkie.

Strategjitë e deritanishme të punësimit në nivel vendor janë thuajse inekzistente. Këtë gjë e tregon edhe niveli i lartë i papunësisë sidomos tek të rinjtë, ndaj një nga sfidat e identifikuar

më shpesh nga komuniteti është domosdoshmëria e planeve strategjike që mund të tërheqin investitorët.

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë, duke përfshirë edhe sektorin e bujqësisë dhe artizanatit, kërkojnë përpjekje serioze të cilat duan angazhimin e ekspertëve dhe politikëbërësve. Një plan i detajuar i zhvillimit ekonomik mbështetur në të dhëna të besueshme do të ofrojë njëmundësi për tërheqjen e investimeve dhe projekteve zhvillimore të territorit, që rrjedhimisht do të kenë impaktin e tyre nëpunësim dhe zbutjen e varfërisë.

Sektori i planifikimit u përball me një sfidë të madhe, duke konsideruar se të dhënat, evidencat dhe statistikat të cilat janë baza e planifikimit nëçdo nivel, mungojnë tërësisht ose nuk janë të zhvilluara në seri kohore për ti shërbyer një ushtrimi planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë siçështë PKS-ja. Për këtë arsye një nga sfidat e bashkisë së re do të jetë edhe zhvillimi i një sistemi statistikor, i cili të prodhojë statistika të besueshme, reale dhe tëstandardizuara.

2. Situata social ekonomike e bashkisë Pogradec

Pogradeci kufizohet në veri me Bashkinë Përrenjas, në perëndim me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Maliq, në juglindje me bashkinë Pustec, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Pogradecit. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km². Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra. Nga pikëpamja administrative Bashkia e Pogradecit ka bashkuar në një të vetme të gjitha njësitë e Rrethit të Pogradecit, duke ruajtur të njëjtët kufij territorialë që ka pasur rrethi. Kësaj ndarje të re territoriale i janë bashkuar edhe disa zona të thella malore.

Tabela 1. Përbërja administrative e territoriale e bashkisë Pogradec³

Bashkia	Njësitë administrative	Qytetet dhe fshatrat respektive
	Pogradec	Qyteti Pogradec
	Udënisht	Fshatrat; Udenisht, Memlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin, Buqez
	Buçimas,	Fshatrat; Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gështënjas, Remenj, Vërdovë, Bahçallëk
	Çërravë	Fshatrat; Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë
	Dardhas	Fshatrat; Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Dërdushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj

³<http://www.vendime.al/ep-content/uploads/2018/12/Bashkia-Pogradec.pdf>

Pogradec	Trebinjë	Fshatrat; Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë
	Proptisht	Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore
	Velçan	Fshatrat; Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë

2.1 Veçoritë Fizike dhe Mjedisore⁴

Bashkia e Pogradecit shtrihet në vijën bregore në jug të liqenit të Ohrit, i vendosur përgjatë kodrave në formën e një teatri, shkallaret e të cilit zbresin drejt liqenit. Qyteti ka një pozicion fushor në lartësinë 694 m mbi nivelin e detit. Në veri-perëndim, Pogradeci ka një relief rrethuar nga një kodër me lartësi rreth 800 m, në të cilën dikur ka ekzistuar një qendër banimi e hershme e Dasaretisë (Enkelana). Në juglindje vijon me fushën e Starovës, pas së cilës vjen sistemi kodrinor jugor, për gjithë rrethinën e tij. Sistemi rrugor është paralel me vijën kryesore bregore ku veçohen dy prej tyre: njëra si shëtitore e qendrës, ndërkaq tjetra është përvijim i rrugës që lidh qytetin me Shën Naumin, e përpara tij me qendrën turistike të Drilonit.

Në territorin e bashkisë gjenden elementë të spikatur territorialë; artificialë dhe natyrore si: liqeni i Ohrit, Parku i Drilonit, Kalaja e Pogradecit, Lumi Shkumbin, Malet e Mokrës etj.

Klima në rajonin e Pogradecit. Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i bashkisë së Pogradecit të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët, me reshje të pakta që bien në formë dëbore.

Temperatura maksimale gjatë verës shkon 36-38 gradë, temperatura mesatare mujore luhetet nga 20 gradë deri në 24 gradë. Gjatë dimrit bien reshje dëbore, ku trashësia shkon në mbi 0.5m, ndërsa në veri në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Klima e territorit tokësor/ujor të Pogradecit është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C.

2.2 Të dhëna demografike

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re e Pogradecit numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil, 90.976 banorë. Njësia me popullsinë më të madhe pas qytetit të Pogradecit është Njësia Administrative Buçimas me 17.792 banorë, ose 20% e totalit të bashkisë. Njësitë

⁴ 2017, ic Consulente, "VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I BASHKISË POGRADEC"

më të vogla të Bashkisë, për nga popullsia, janë Dardhas me 3.794 banorë, Trebinja me 3.355 banorë dhe Velçani me 2.716 banorë.

Në tabelën më mëposhtme paraqiten të dhënat e regjistrit të Gjendjes Civile për çdo njësi administrative të bashkisë së Pogradecit të disagreguara sipas grupmoshës dhe gjinisë. Kështu rreth 17% e popullsisë, sipas Gjendjes Civile, është e moshës 0-14 vjeç, rreth 72% e popullsisë është në moshën 15-64 vjeç që nënkupton moshën aktive për punë dhe 10% e popullsisë është në moshën 65 vjeç e lart, që është edhe moshë ekonomikisht jo-aktive. Struktura moshore e popullsisë së Bashkisë së Pogradecit tregon një potencial të madh përsa i përket segmentit ekonomikisht aktiv të popullsisë (15-64 vjeç). Në kushtet e nxitjes së mundësive për punësim, ky segment ofron një motor të burimeve njerëzore që mund të shtyjë pozitivisht zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Por nga ana tjetër Bashkia duhet t'i përgjigjet këtij segmenti me politika që nxisin punësimin.

Tabela 2. Të dhëna për numrin e popullsisë dhe numrin e familjeve sipas njësi administrative

Njësitë	Popullsia	% ndaj totalit	Nr. Familjeve	Gjinia		Grupmoshat		
				Meshkuj	Femra	0-14	15 -64	>65
Pogradec	36,842	41%	12,367	18,453	18,389	5,560	27,391	3,891
Buçimas	17,792	20%	5,259	9,140	8,652	3,397	12,635	1,751
Çërravë	9,201	10%	2,924	4,797	4,404	1,676	6,518	1,007
Udënisht	10,920	12%	3,547	5,629	5,291	2,128	7,758	1,013
Proptisht	6,106	7%	1,941	3,208	2,898	1,276	4,254	537
Trebinjë	3,355	4%	1,178	1,762	1,593	520	2,419	416
Velçan	2,716	3%	917	1,422	1,294	528	1,922	266
Dardhas	3,794	4%	1,283	1,952	1,842	653	2,747	373
Total	90,726		29,416	46,363	44,363	15,738	65,644	9,254
%				51%	49%	17%	72%	10%
Urbane	41%							
Rurale	59%							

Burimi i informacionit: Drejtoria e Gjendjes Civile Pogradec

Raporti gjinor në Bashkinë e Pogradecit është i balancuar, 51% meshkuj dhe 49% femra. Tendenca demografike për disa nga njësitë administrative (kryesisht atyre që janë buzë liqenit) ka qenë rritëse. Në njësinë administrative Buçimas, nga viti 1991 në 2015 popullsia është dyfishuar për shkak të ardhjeve të shumta nga zona e malësisë së Mokrës. Në Proptisht, banorët janë larguar për të siguruar kushte më të mira jetese e mundësi më të mira për punësim, por një pjesë e tyre vazhdon të kthehet në stinën e pranverës e të verës për të punuar tokat. Në Trebinjë popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes së vazhdueshme migratore drejt Vërdovës, Starovës, qytetit të Pogradecit, dhe emigrimit (kryesisht drejt Greqisë). Banorët janë larguar për të siguruar kushte më të mira jetese e mundësi më të mira për punësim, por një pjesë e tyre vazhdon të kthehet në stinën e verës, për të punuar tokat.

Shtesa natyrore negative, migrimi dhe emigrimi kryesisht i popullatës aktive, kanë qenë faktorë të rëndësishëm të cilët kanë përcaktuar edhe tendencën e plakjes së popullsisë me ritme të shpejta. Procesi i plakjes vihet re nga rritja e lehtë e popullsisë me 65 vjeç.

Tabela 3. Numri i lindjeve dhe vdekjeve për dy vitet e fundit në Bashki në Pogradec

	2017	2018
Lindje	212	168
Vdekje	213	165
Martesa	186	171

Burimi i informacionit: Bashkia Pogradec

Nga pikëpamja e dendësisë dhe shpërndarjes demografike e kombinuar me pozicionin gjeografik (lidhja me bregun liqenor) vlerësohet se qyteti i Pogradecit, Njësia e Buçimas dhe Njësia e Udënishtit, kanë një vijimësi-lidhje urbane. Kjo 3-she njësi përbën edhe 73% të popullsisë së gjithë bashkisë. Raporti dizavantazhues që ka Bashkia e Pogradecit në lidhje me popullsinë urbane kundrejt popullsisë rurale (me shumicë popullsi rurale) zbutet dukshëm nga trajtimi i kësaj “makro-njësie” urbane⁵.

2.3 Arsimi

Institucionet e edukimit parashkollor (çerdhe dhe kopshte). Nisur nga standardet evendosura do të duheshin rreth 33,000 m² sipërfaqe ndërtimi për këto struktura. Sipas standardeve të adoptuara, Bashkia e Pogradecit ka nevojë për 22 çerdhe, prej të cilave 9 kërkohen vetëm brenda qytetit të Pogradecit. Ndërkohë qyteti aktualisht ka vetëm një çerdhe funksionale. Aktualisht Bashkia e Pogradecit ka 47 kopshte në territorin e saj, ndërkohë që sipas standardit do të duhej të kishte shumë më pak. Ky disbalancim ndërmjet numrit të nevojshëm të çer dhe kopshteve do të duhet të balancohet nga Bashkia e Pogradecit nëpërmjet lejeve të zhvillimit të aktivitetit të kopshteve private. Në këtë mënyrë mund të

⁵https://www.academia.edu/36074259/Plani_i_P%C3%ABrgjithsh%C3%ABm_Vendor

sistemohet edhe problemi që ekziston për mungesën e kopshteve në fshatrat pak më larg qytetit të Pogradecit ku nevojitet të ketë më shumë kopshte të vogla për të mbuluar gjeografikisht këto zona.

Tabela4. Të dhëna për arsimin parashkollor

Cerdhet			Kopshtet		
Numri i çerdheve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve
1	50	5	47	714	134

Burimi i informacionit: Bashkia Pogradec

Shkollat 9 vjeçare.Bashkia e Pogradecit ka një numër të madh shkollash 9-vjeçare të shpërndara në territor (53 shkolla), të cilat, nëse bazohemi në standardet e kërkuara janë me hapësira të vogla për nxënësit. Pra, ndërsa parametri i numrit të kërkuar të shkollave sipas popullsisë (1 shkollë për 6,000 banorë) është tejkaluar, hapësirat e kërkuara për nxënës, sipas standardeve, janë të vogla. Sipas rregullores duhet të parashikohet 20-25 m² për nxënës ndërkohë që për shumicën e shkollave, në Pogradec kjo nuk shkon më shumë se 4-8 m² /nxënës.

Tabela 5. Të dhëna për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm

Shkollat 9-vjeçare		Shkollat e mesme	
Numri i shkollave 9-vjeçare	Numri i nxënësve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve
53	6,763	38	2,412

Burimi i informacionit: Bashkia Pogradec

Shkollat e mesme.Ashtu si në rastin e shkollave 9-vjeçare, edhe në rastin e shkollave të mesme, duket se numri i shkollave, nëse i referohet standardit të parë (1 shkollë për 9,000 banorë), është i realizuar dhe tejkaluar pasi nga 6 shkolla që “kërkohen sipas standardit” janë aktualisht 38 të tilla. Megjithatë, Bashkia e Pogradecit ka nevojë për hapësira më të mëdha për nxënësit e shkollave të mesme që të mund të respektojë standardin e rregullores së Planifikimit Vendor (20-25 m² për nxënës). Sipas llogaritjeve janë rreth 53,000 m² hapësire e re që duhet shtuar për shkolla të mesme.

Sipas informacionit të siguruar nga Bashkia Pogradec, në planin e zhvillimit vendor, është parashikuar zgjidhja nëpërmjet zgjerimit të hapësirave ekzistuese të shkollave të mesme dhe më tej do të konsiderohet si alternativë të dytë, mundësia e ndërtimit të ndonjë ndërtese të re, veçanërisht për ndërtimin e një shkollë të mesme profesionale, e cila aktualisht funksionon në një ambient privat. Në një të ardhme afat-mesme, Bashkia mund të konsiderojë që nxënësit në moshë për shkollë të mesme të njëjësive administrative Velçan dhe Trebinjë (për shkak të numrit relativisht të vogël) të mund t’i dërgojë me transport në shkollat e njëjësive të tjera

(pranë tyre) ndërkohë që ndërtesat e këtyre shkollave të mund t'i adoptojë për nevoja të tjera (kopshte, çerdhe apo shkolla 9-vjeçare).

2.4 Ekonomia në Bashkinë Pogradec

Pogradeci në të kaluarën ka qenë një qendër e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur në atë kohë janë industria e kromit, e hekurit, e nikelit, e qymyrit, e peshkimit, e përpunim drurit dhe të pijeve. Sot, Liqeni i Ohrit është një pikë e rëndësishme referimipër ekonominë e qytetit të Pogradecit dhe disa fshatra që shtrihen përgjatëtij, si Udënisht, Buçimash, Lin, Tushemisht dhe Volorekë. Popullsia e kësaj zone orientohet drejt ekonomisë së lidhur me turizmin, industrinë e mikpritjes, peshkimin dhe fermat e rritjes së peshkut. Veç kësaj, sektori i artizanatit, i cili ofron mundësi punësimi sidomos për gratë në zonat rurale, ka hedhur hapat e parë drejt zhvillimit dhe bashkisë do ti duhet që të mbështesë dhe nxisë rritjen e kapaciteteve të punësimit në këtë sektor.

Duke ju referuar të dhënave për vitin 2018 nga Sporteli i shërbimit të QKB-së në bashki rezultojnë të regjistruara 296 biznese te reja.

2.5 Punësimi dhe papunësia

Statistikat e tregut të punës janë thelbësore për hartimine Planit të Kujdesit Social. Shkalla epunësimit (raportii të punësuarve kundrejt popullsisë në moshë pune), dhe ajo e papunësisë (raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës) janë tregues social kyç. Ky seksion i dokumentit siguron informacion mbi të dhënatë punësimit dhe papunësisë kryesisht nga Zyra e Punës Pogradec, duke përfshirë edhe një analizë të bazuar në të dhëna të disagreguara sipas moshës.

Tabela 6. Shkalla e punësimit për vitet 2016, 2017 për Bashkinë

Mosha	Gjinia	Viti 2016	Viti 2017	Mesatarja e vendit 2017 ⁶
15 vjeç e lart	Meshkuj	0	0	57.1
	Femra	0	17	43.5
	Total	0	17	50.3
15-64 vjeç	Meshkuj	42	20	64.3
	Femra	39	17	50.3
	Total	81	37	57.4
15-29 vjeç	Meshkuj	40	44	38.5
	Femra	54	37	28.3
	Total	94	81	33.8
30-64 vjeç	Meshkuj	10	12	77.9
	Femra	19	13	60.0
	Total	29	25	68.7

Burimi: Zyra Vendore e Punës

Papunësia në Bashkinë e Pogradecit sipas të dhënave nga Censsus 2011, është në nivele shumë të larta. Për qytetin e Pogradecit kjo shifër është 35%, ndërkohë që mesatarja

⁶Burimi i informacionit: INSTAT Anketa e Forcave të Punës 2013-2017

kombëtare është në nivelin 29%. Ndërkohë që në disa njësi administrative është edhe më e lartë (Buçimas 54.7%, Velçan 62,6%, Udënisht 67.6%).

Tabela 7. Shkalla e papunësisë për vitet 2016, 2017 për Bashkinë Pogradec

Mosha	Gjinia	Viti 2016	Viti 2017	Mesatarja e vendit 2017
15 vjeç e lart	Meshkuj	0	0	14.6
	Femra	0	1	12.6
	Total	0	1	13.7
15-64 vjeç	Meshkuj	49	43	15.1
	Femra	74	46	12.8
	Total	123	89	14.1
15-29 vjeç	Meshkuj	21	10	27.0
	Femra	21	31	24.0
	Total	42	41	25.9
30-64 vjeç	Meshkuj	46	43	11.3
	Femra	50	32	10.1
	Total	96	75	10.8

Burimi: ZV e Punës

2.6 Shëndetësia

Një rëndësi të veçantë në shërbimin shëndetësor ka shërbimi parësor. Në Bashkinë Pogradec ky shërbim ofrohet nëpërmjet 11 qendrave shëndetësore dhe 58 ambulancave. Nga një analizë e bërë në vitin 2018 mbi performancën e shërbimit parësor shëndetësor mbështetur në një vëzhgim të shoqërisë civile me pjesëmarrjen e qytetarëve në Bashkinë e Pogradecit⁷, vërejmë se shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor në këtë bashki ka disa probleme lidhur me shërbimet ndaj grupeve të prekura.

Kështu në rastet e ekzaminimit të viktimave të dhunës, qendrat shëndetësore të Bashkisë Pogradec kanë mungesa në dhomat e ekzaminimit dhe nuk ofrojnë mjedise të privatësisë për pacientët gjatë vizitës. Privacia ofrohet vetëm në 40 % të tyre. Nga ana tjetër për shkak të një bashkëpunimit shumë të dobët që këto qendra kanë me Bashkinë Pogradec, rastet e dhunës raportohen në mënyrë të menjëhershme në Bashkinë Pogradec vetëm në 39 % të tyre.

Gjithashtu, 89% e qendrave kanë raportuar mospërfshirjen e Bashkisë Pogradec në aktivitetet me karakter promociional, edukues dhe informues në komunitet duke bashkëpunuar me stafin e qendrave të kësaj bashkie.

Përshtatshmëria e QKSHP-ve për pacientët PAK. QKSHP-të në Bashkinë e Pogradec ofrojnë në një masë shumë të vogël lehtësira për përshtatshmërinë e tyre në lidhje me funksionimin për personat me aftësi të kufizuara. Asnjë nga 37 ambulancat nuk janë të përshtatur për pacientët me aftësi të kufizuara, me rampa ose/dheashensor, ndërkohë që po në nivele të ulëta, me vetëm 5 % këto lehtësi e ofrojnë qendrat shëndetësore.

⁷ 2018, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, "Monitorimi i Qendrave të Kujdesit Shëndetësor parësor".

Gjithsej janë 57QKSHP në Bashkinë Pogradec dhe vetëm 2 % e tyre kanë kryer përshtatje përpacientët që kanë aftësi të kufizuara. Një situatë e njëjtë ofrohet pranë QKSHP-vetë kësaj bashkie edhe në lidhje me medhomat e përshtatura për këtë kategoripacientësh. Në total vetëm 4% e tyre kanë lehtësira të tilla për pacientët me aftësi të kufizuara. E njëjta problematikë haset edhe në banjat e përshtatura për këta pacientë. Në total vetëm 2% e QKSHP-ve kanë kryer përshtatje të tilla për t'ju ardhur në ndihmë pacientëve me aftësi të kufizuara.

3. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe financiare të Bashkisë Pogradec për të ofruar shërbime sociale

3.1 Shërbimi Social në Bashkinë Pogradec

Aktualisht ka mangësi në mbulimin e nevojave për shërbime sociale të grupeve në nevojë në Bashkinë Pogradec. Shërbimet e Kujdesit Social, të cilat janë pjesë e programit lokal të mbrojtjes sociale janë tërësisht të pamjaftueshme si për sa i përket kapaciteteve për të ofruar shërbimet, ashtu edhe profesionistëve dhe njohurive për të ofruar shërbime të përshtatshme sipas nevojave. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që mund të mbulojë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase, veçanërisht në zonat rurale. Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jo-fitimprurëse të financuara në baza vullnetare ose nga organizatat e huaja financuar nga donatorët dhe partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonën urbane (90% janë në zonat urbane).

Shërbimet e kujdesit social përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 5%) të shpenzimeve totale të Fondit për mbrojtjen sociale ku pjesën më të madhe të shpenzimeve vjetore e zënë Ndihma Ekonomike dhe PAK⁸. Krijimi dhe ngritja e një sistemi funksional dhe efektiv të kujdesit shoqëror (e një pakete bazë të shërbimeve) të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale, mbetet sfida kryesore për shërbimet e kujdesit shoqëror. Ndërgjegjësimi i autoriteteve bashkiake, financimi i tyre, mbulimi i të gjithë territorit të bashkisë me këto shërbime dhe planifikimi mbi evidencat janë çështje kyçe të cilat duhet të përfshihen në PKS-së.

3.2 Struktura e Drejtorisë së Shërbimit Social Pogradec

Drejtoria e Shërbimit Social të Pogradecit ka në varësinë e saj katër sektorë që janë: Sektori i Ndihmës ekonomike dhe Shërbimi Social; Sektori i Strehimit; Sektori i Mbështetjes së Nënës dhe Fëmijës; Sektori i Nxitjes së Punësimit. Secili nga sektorët ka detyrat dhe përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale.

Misioni i Drejtorisë së Shërbimit Ndihmës dhe Shërbimit Social Pogradec është evidentimi i grupeve në nevojë brenda territorit të Bashkisë Pogradecit dhe mbështetja me ndihmë

⁸<https://portavendore.al/>

ekonomike dhe shërbime sociale. Por ndërsa mbështetja me ndihme ekonomike realizohet sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet sociale janë tërësisht të pamjaftueshme dhe pothuajse in-ekzistente në disa zona të bashkisë.

Tabela 8. Struktura e Shërbimit Social të Bashkisë Pogradec

Drejtoria e Shërbimit Social Pogradec	Nr. i punonjësve dhe profili *
Drejtori i Shërbimit Social të Pogradecit	1 Drejtor
Zyra e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimi Social	4 Specialist për Ndhmën Ekonomike 1 Specialist komuniteti rom dhe egjiptian
Zyra e Strehimit	1 Specialist për Strehimin
Zyra e Mbështetjes së Nënës dhe Fëmijës	1 Specialist NJMF
Zyra e Nxitjes së Punësimit	1 Specialist Punësimi
Zyra e Gjendjes Civile	3 Specialist
Zyra e Barazisë Gjinore	1 Specialist

*Kjo strukture është vetëm për qytetin.

3.3 Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

Në kuadrin e reformimit të tyre, skemat e NE-së dhe PAK-ut janë përmirësuar ndjeshëm në drejtim të efikasitetit dhe barazisë në trajtimin e familjeve dhe individëve në nevojë si dhe në rritjen e aksesit dhe sigurimin e transparencës.

Tabela 8. Numri i punonjësve të shërbimit social sipas njësive administrative dhe funksionit

Njësia Administrative	Numri i punonjësve dhe funksioni
Buçimas	2 Admins Shoqërore (1 PAK+ 1 NE)
Çërravë	2 Admins Shoqërore (1 PAK + 1 NE)
Udënisht	2 Admins Shoqërore (1PAK + 1 NE)
Trebinjë	2 Admins Shoqërore (1 PAK+1NE)
Dardhas	1 Admins Shoqërore (PAK+NE)
Proptisht	2 Admins Shoqërore (1 PAK+ 1NE)
Velçan	1 Admins Shoqërore (PAK+NE)
Pogradec	6 Admins Shoqërore (1 Specialist punësimi +4 NE+1 Specialist strehimi 1 specialist barazi gjinore 1 NJMF dhe komuniteti rom e egjiptian)
Totali	21 punonjës

Sfidat më të rëndësishme në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike është kthimi nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të ri-integrimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit dhe rritja e efikasitetit të saj.

Mbulimi më i mirë i familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër është një kusht i domosdoshëm për çdo bashki.

Pagesamujore që përfitojnë familjet e varfëra nga skema e Ndihmës Ekonomike është më e ulët se pagesa e aftësisë së kufizuar. Konkretisht shumica e pagesës mesatare është 3,800 Lek në muaj si ndihmë ekonomike ndërsa ajo e aftësisë së kufizuar është 9,900 L në muaj. Për këtë arsye është qartë se numri i përfituesve ka ndryshuar nga një kategori tek tjetra. Në bashki janë 9 administratore shoqërore që merren me problemet e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës.

3.4 Shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror

Organizatrat aktive në qytetin e Pogradecit ofrojnë shërbime sociale në fusha të ndryshme si:

- mbështetje për komunitetin Rom dhe Egjiptian;
- mbështetje për target grupin e personave që janë me aftësi të kufizuar duke i pajisur ato me proteza;
- mbështetje social-psikologjike për personat e dhunuar fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht;
- lobim në institucionet vendore dhe qendrore të vendit për të drejtat e barazisë gjinore;
- mbështetje e fëmijëve jetimë

Referuar Hartësë Shërbimeve Sociale⁹, në Bashkinë e Pogradecit (referuar kryesisht qytetit) funksionojnë:

1. Shërbime Sociale për Fëmijë:
 - a. Shërbime Rezidenciale për Fëmijë (1 qendër)
 - b. Shërbime Ditore për Fëmijë (1 qendër)
2. Shërbime Sociale për të Moshuar
 - a. Shërbime Ditore për të Moshuar (1 qendër)
3. Shërbim në Familje Shërbime për Persona me Aftësi të Kufizuar
 - a. Shërbime Rezidenciale për PAK
 - b. Shërbime Ditore për PAK (4 qendra)
4. Shërbim në Shtëpi Shërbime Sociale për Gra të Dhunuara/Viktima Trafikimi
 - a. Shërbime Ditore
 - b. Shërbime Rezidenciale
5. Shërbime të tjera Komunitare

⁹<http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/11/Bashkia-Pogradec.pdf>

3.5 Zyra e mbështetjes së Nënës dhe Fëmijës

Bashkia Pogradec ka sot zyrën për barazi gjinore dhe luftë kundër dhunës në familje, e cila mban një bazë të dhënash për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe bën rakordimin e veprimeve midis institucioneve shtetërore dhe OJF, për rastet e lëshimit të Urdhrave të Mbrojtjes. Kjo njësi grumbullon dokumentacionin përkatës, për dhunë në familje dhe bën përpjekje për t'ia referuar institucioneve sipas veprimtarisë së tyre në ndihmë të grave dhe familjeve në nevojë. Janë ngritur strukturat e nevojshme të identifikimit të rasteve, të trajtimit të problemeve të ndryshme, të përgjegjësve për zbatimin e ligjit dhe vendimeve e udhëzimeve të dala prej tij, informohen viktimat e dhunës në familje, ose familjarët e tyre, për shërbimet aktuale ekzistuese, sociale, që shoqata të ndryshme që ofrojnë dhe operojnë në qytet.

Në Bashkinë Pogradec **Mekanizmi Referimit** i cili bazohet në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në marrëdhëniet Familjare”, neni 8, pika 8 si dhe te VKM 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit tëpunëspër referimin e rasteve tëdhunës nëmarrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, hartuar në mbështetje të bazës legjislative të sipërcituar. Në përbërje të këtij mekanizmi janë: një punonjës i NJMF-së, një punonjës i barazisë gjinore, një punonjës nga policia, gjykata ose prokuroria, spitali dhe organizata që operojnë në territorin e bashkisë. Grupi i punës mbledhet çdo tremuaj për të diskutuar mbi rastet.

Viktimave të dhunës iu ofrohet konsulencë psikologjike falas, konsulencë ligjore falas, paketë ushqimore dhe veshmbathje në raste të veçanta nga skema Ndihmës Ekonomike, kushte shkollore për fëmijët e tyre, kur familjet janë në nevojë formim profesional të diferencuar nga zyra e punësimit, konsulencë mjekësore falas.

Nga ana e stafit të zyrës për mbështetjen e nënës dhe fëmijës, ngrihet shqetësimi për një përgatitje të një niveli më të lartë teorik e praktik të specialistëve të trajtimit të këtyre rasteve nga ekipi teknik dhe trajnime specifike të aktorëve që trajtojnë rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

3.6 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social në Bashkinë e Pogradecit ka bërë dhe bën përpjekje e maksimale për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet lokale apo dhe qendrore, por hendeku i plotësisimit të këtyre nevojave është akoma në dukje.

Gjatë diskutimeve me grupet e interesit, u theksua nevoja për të verifikuar situatën sociale të grupeve vulnerabël si dhe për të evidentuar nga pikëpamja sasiore dhe cilësore të nevojave për shërbime në territorin e bashkisë së Pogradecit. Vetëm duke pasur një hartë të qartë të nevojave dhe mundësive dhe potencialeve për të ofruar shërbime sipas nevojave, mund të planifikohen masa afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e jetës sociale të komunitetit. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që krahas identifikimit të nevojave për shërbime

tëbëhet edhe kostimi tyre, si një mjet për hartimin e buxhetit lokal të bashkisë dhe aplikimeve për fonde extra lokale siç janë fondi social apo fonde të donatorëve.

Megjithëse numri i shoqatave që ofrojnë shërbime sociale në qytetin e Pogradecit është shumë i ulët dhe kategoritë për të cilat ato ofrojnë shërbime është shume ikufizuar, përsëri të dhënat për përfituesit e shërbimeve nuk ekziston. Në mënyrë që të racionalizohen burimet, është e domosdoshme që Drejtoria e Kujdesit Social të ketë një databazë me të gjithë informacionin për shërbimet e ofruara individëve, familjeve dhe grupeve vulnerabël. Ky informacion do të ndihmojë edhe bashkëpunimin me shoqata private të specializuara në fusha të ndryshme, për të bplotësuar spektrin e shërbimeve, si dhe duke vënë në dispozicion asete vendore për të ngriturqendra të ofrimit të shërbimeve të ndryshme, si dhe shtimin në buxhetin e saj të zërit të investimevedhe në fushën sociale, me politika të qarta për mbështetjen e kategorive në nevojë, zgjerimin emundësive për aftësim dhe punësim për kategoritë në nevojë.

Krijimi dhe ngritja e një sistemi funksional dhe efektiv të kujdesit shoqëror (e një pakete bazë tëshërbimeve) të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupevulnerabël në programet e mbrojtjes sociale, mbetet sfida kryesore për shërbimet e kujdesitshoqëror. Ndërgjegjësimi i qytetarëve në nivel bashkive si dhe financimi janë çështje kyçe, si dhe mbulimi i të gjithë territorit të Bashkisë me këto shërbime, një planifikim më i mirë është i domosdoshëm për tëndihmuar dhe procesin e financimit, si dhe trajnimi i stafit që punon me çështjet sociale.

Shërbimi social i bashkisë parashikohet të marrë një vëmendje më të madhe në vazhdim për faktin se në çdo njësi administrative parashikohet të ngrihen *“Njësitë për Vlerësimi dhe Referimin e Rasteve”* të përbërë nga sektori i pagesave “në para”(ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj.) dhe sektori i përkujdesit dhe përfshirjes sociale (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve). Propozohet të përfshihen në këtë njësi, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësi i dhunës në familje, si dhe të përcaktohen nëpunësit zbatues për programet e riintegrit social. Me ngritjen e kësaj njësie vetë bashkia dhe organet e saj do jenë më afër problemeve të komunitetit, me qëllim zgjidhjen e tyre.

Funksionet kryesore të NJVNRR/sektori i përkujdesit social janë identifikimi i rasteve; këshillimi dhe hartimi i planeve individuale të përkujdesjes; ndërmjetësimi dhe referimi në shërbime sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar; si edhe ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i rasteve. Kjo njësi do të funksionojë si një zyrë që ofron të gjitha shërbimet me një ndalesë dhe të shërbejë si një pikë kryesore hyrjeje për qytetarët që mundëson referim të menjëhershëm të rasteve në bashkëpunim me Drejtoritë e Shërbimeve Shoqërore në nivel bashkie. Kjo mund të shërbejë për të përmirësuar bashkërendimin dhe mekanizmat e referimit si edhe administrimin e rasteve.

Hapja e kësaj njësie paraqet për Bashkinë një sfidë për të bërë menaxhimin e saj sipas standardeve, nisur që tek stafi apo edhe tek shërbimet që duhet të ofrojë. Bashkia do të rrisë numrin e punonjësve që ofrojnë shërbime të kujdesit social për të zgjidhë sa më shpejt që është e mundur problemet në komunitet. Punonjësit socialë do të jenë figurat profesionale në

njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jenë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

Nisur nga vlerësimet që janë bërë për stafin e Bashkisë Pogradecit, rezultojnë të jetë një bashki me staf të kualifikuar dhe të dedikuar në shërbimet që ofron. Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre mbetet e përhershme për faktin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e viteve dhe në kuadrin e reformës territoriale. Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofroj shërbime sa më koherente dhe me standarde. Plotësimi i nevojave të popullatës është prioriteti i punës së Drejtorisë së Shërbimit të Kujdesit Social, duke qenë se edhe nevojat ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, stafi shprehet i gatshëm që ti mbulojë këto nevoja me një shërbim të kualifikuar.

Një sfidë tjetër që paraqitet është menaxhimi apo monitorimi i bashkisë nga organizatat që ofrojnë shërbime të kujdesit social. Bashkia ka në fokus të saj plotësimin e nevojave sociale dhe normalisht mirëpret organizatat jo-qeveritare që të japin kontributin e tyre duke ju garantuar terrenin. Por bashkia nga ana tjetër merr përgjegjësinë që tu kërkojë këtyre organizatave që ofrojnë shërbime cilësore dhe të kenë staf të kualifikuar për plotësimin e nevojave të popullatës në mënyrë profesionale.

3.7 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Pogradec

Shërbimet Sociale, shpesh herë ndodh që të mos jenë prioritet i politikave lokale qeverisëse dhe kjo shprehet nga buxheti i kufizuar që iu vihet në dispozicion në total dhe duke e krahasuar si me buxhetin e shtetit ashtu edhe me buxhetin e bashkisë. Për Bashkinë e Pogradecit mund të themi, se ka një parashikim në rritje të buxhet afatmesëm për sa i përket programeve buxhetore që mbulojnë funksionet 25, 26, dhe 27 të bashkisë, përkatësisht programet “Familja dhe fëmijët”, “Papunësia” dhe “Strehimi Social”. Ndryshimet në Ligjin e Buxhetit, i kanë deleguar bashkive kompetenca të reja dhe fleksibilitet sa i përket menaxhimit të fondeve sipas nevojave, por për shkak se nuk është miratuar ende si ligj, veprohet me ligjin e vjetër, që do të thotë se bashkia nuk mund t’i përdorë fondet për nevojat e shërbimeve që ka.

Burimet financiare për shërbimet sociale ofrohen pjesa më e madhe nga qeveria qendrore që janë buxhetet që miraton qeveria për shpërndarje në secilën bashki për plotësimin e këtyre shërbimeve. Qeveria qendrore është ofruesi më i fuqishëm i shërbimeve sociale, nëpërmjet programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor. Është përgjegjësia e saj të menaxhojë, koordinojë, financojë e mbikëqyrë zbatimin e politikave sociale.

Qeveria vendore është aktor kyç, në sigurimin e shërbimeve sociale dhe kompetencat e saj janë duke u zgjeruar hap pas hapi nëpërmjet decentralizimit, por buxhetet për këto shërbime ngelen akoma shumë të kufizuara.

Bashkia me vendimet e Këshillit Bashkiak është përfshirë në realizimin dhe plotësimin e nevojave që paraqet komuniteti për shërbime sociale, në dhënien e pagesave në kesh për

individët apo familjet në nevojë duke menaxhuar në këtë formë kryesisht fonde që vijnë nga buxheti i shtetit.

3.8 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesjes sociale në Bashkinë e Pogradecit

Organizatat aktive në qytetin e Pogradecit ofrojnë shërbime sociale në fusha të ndryshme si psh: Mbështetje për komunitetin Rom dhe Egjiptian; mbështetje për target grupin e persona që janë të gjymtuar duke i pajisur ato me proteza; mbështetje social-psikologjike për personat e dhunuar fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht; lobim në institucionet vendore dhe qendrore të vendit për të drejtat e barazisë gjinore; mbështetje të fëmijëve jetimë; mbështetje për fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Shoqatat aktive në qytetin e Pogradecit janë: “Unë Gruaja”, “Shkolla Amaro – Tan (pjesë e organizatës Nehemia)”, “Fëmijët jetimë”.

Shoqata “Shërbesa e Ujit te Gjallë”, e cila ofron mbështetje për fëmijët dhe familjet në nevojë. Është qendër ditore që ofron një vakt dreke dy here në javë në fshatra.1,200 fëmijë me një vakt dreke dhe me ushqime për familjet e tyre.

Fondacioni “Nehemia”, ofron mbështetje për të moshuarit, ndihma humanitare, mbështetje për restaurime shkollash, lokalesh, shërbime sociale e mjekësore, një vakt dreke për njerëz në nevojë.

Qendra “Drita e Shpresës”, ofron shërbime fizioterapie për personat me aftësi të kufizuar, prodhim protezash e ortezash në punishte.

Fondacioni Diakonia Albania, është një Qendër rezidenciale jo publike që ofron shërbime për njerëzit në nevojë, kryesisht fëmijë të grupmoshës 16-18 vjeç. Kapaciteti maksimal i saj është 20 persona ndërsa aktualisht ajo numëron 24 persona.

Qendra Ditore për PAK, është një qendër publike që ofron mbështetje për personat me aftësi të kufizuar. Kapaciteti maksimal i saj është 43, ndërsa për momentin kjo qendër ka 32 persona.

Shoqata "Foleja", funksionon si një qendër ditore jopublike e cila ofron shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar. Kapaciteti maksimal i saj është 12 persona, ndërsa shoqata për momentin ka 9 persona që e frekuentojnë dhe marrin shërbime.

3.9 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimmarrje të informuar

Vendimmarrja e informuar përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të mirëfunksionimit të qeverisjes vendore. Duke vlerësuar kapacitetet vendore për të mbledhur të dhëna dhe informacione për individët dhe grupet në nevojë, e kuptojmë se ka një hendek të dhënash dhe nevojë imediate të bashkisë për të ndërtuar një data bazë me të dhëna të besueshme dhe të përditësuara. Në përgjithësi rezulton se vendimmarrja bazohet kryesisht në të dhëna empirike dhe të pa verifikuara me institucionet e tjera në nivel vendor. Një problem kryesor në këtë aspekt është mungesa e një punonjësi/zyre statistikore si dhe mungesa e një sistemi të integruar të dhënash. Për shembull, mungesa e statistikave në lidhje me numrin e fëmijëve

me probleme sociale në territorin e bashkisë, ndikon drejtpërdrejt në një planifikim jo të mirë të shërbimeve ose përgatitjen e projekteve për këtë kategori sociale. Po kështu, nga grupet e interesit gjatë procesit të hartimit të Planit, u artikulua nevoja imediate për shërbime për moshën e tretë, por të dhënat për individët e moshuar të vetmuar apo me nevoja për shërbime shëndetësore në familje, mungojnë tërësisht.

4. Nevojat për shërbime sociale të grupeve vulnerabël dhe atyre në risk

4.1 Familjet e varfëra

Varfëria është një nga shkaqet kryesore të përjashtimit social. Niveli i lartë i varfërisë, sidomos për zona të caktuara, në Bashkinë e Pogradecit konfirmohet edhe nga të dhënat që ekzistojnë për përfituesit e Ndhmës Ekonomike. Sipas të dhënave të bashkisë, referuar Ligjit Nr.44//2016 “Për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, janë 4,509 familje në të gjithë bashkinë që trajtohet me ndihmë ekonomike, duke përbërë rreth 16% të totalit të gjithë familjeve, sipas regjistrit të gjendjes civile. Duke marrë parasysh faktin që regjistri i gjendjes civile përgjithësisht ka një numër popullsie më të madhe se sa ajo që është realisht prezente në zonë (përfshin emigracionin dhe migrimin i brendshëm) kjo shifër (16%) është edhe më e madhe në realitet.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin mesatar të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike sipas njësie administrative të Bashkisë Pogradec. Duke veçuar qytetin e Pogradecit dhe Njësinë Administrative Buçimas (ku trajtohen respektivisht 7% dhe 12% e familjeve të regjistruara në gjendjen civile) në të gjitha njësitë e tjera shifrat janë shumë të larta, duke shkuar deri në pothuajse 1 në 3 familje të trajtuara me Ndhmë Ekonomike në Velçan, Udenisht, Trebinjë apo Dardhas.

Tabela 9. Numri i Familjeve me Ndhmë Ekonomike sipas Njësie Administrative

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Total i familjeve	Familje me ndihmë ekonomike	Familje me ndihmë fondi 6%	% e familjeve me Ndhmë Ekonomike
1	Pogradec	12,367	436	70	4%
2	Buçimas	5,259	755	25	15%
3	Trebinjë	1,178	329	3	28.1%
4	Proptisht	1,941	536	6	27.9%
5	Çërravë	2,924	727	13	25.3%
6	Dardhas	1,283	359	3	28%
7	Udenisht	2,264	566	12	25.5%
8	Velçan	917	313	0	34.1%
	TOTALI	28,133	4021	132	

Burimi: Sektori i Ndhmës Ekonomike – Bashkia Pogradec

Bashkia e Pogradecit (me fonde të deleguara) paguan rreth 17 milion lekë në muaj për këto familje. Duhet specifikuar që shuma mesatare që përfitojnë familjet në ndihmë ekonomike është rreth 3,700 lekë/muaj.

Nisur nga shifrat, shikojmë qënjësia administrative Velçan ka përqindjen më të lartë të familjeve të varfëra të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, rreth 34% të numrit të familjeve që jetojnë në këtë njësi. Trebinjë, Dardhas dhe Proptisht kanë të njëjtin nivel varfërie rreth me rreth 28% të familjeve në skemë. Ndërsa qendra Pogradec ka numrin më të ulët të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, 506 familje ose 4% e totalit të familjeve të kësaj njësie.

4.2 Personat me aftësi të kufizuar

Aktualisht Bashkia Pogradec numëron 1,589 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët 444 janë 0-18 vjeç, 352 janë 18-25 vjeç, dhe 766 janë 25+ vjeç. Gjithashtu në këtë Bashki ka edhe 1,931 persona janë invalidë pune.

Misioni i skemës së “Pagesës së Aftësisë së Kufizuar” (PAK) është sfida për të përmirësuar cilësinë e jetesës së personave me aftësi të kufizuar jo vetëm nëpërmjet ndihmës monetare por edhe nëpërmjet shërbimeve të kujdesit social për këtë kategori. Por aktualisht “Pagesa në para” është mekanizmi i vetëm për mbështetje të tyre. Megjithatë masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më e lartë se masa e NE-së, përsëri ajo është e pamjaftueshme për të përballuar disa shërbime të kujdesit social, për të cilat ka nevojë njëperson me aftësi të kufizuara.

Tabela 10. Numri i personave me aftësi të kufizuar (dhe invalidë pune) dhe fondi mujor i shpenzuar për çdo njësi administrative (viti 2016).

Njësitë	Nr. i personave	Pagesa PAK
Pogradec	1,945	15,342,635
Buçimas	730	6,628,390
Trebinjë	206	2,152,165
Proptisht	317	2,655,785
Çerravë	447	4,591,430
Dardhas	161	1,828,875
Udenisht	347	2,792,872
Velçan	199	1,724,526
Totali	4,352	37,716,678

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Pogradec

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, numrin më të madh të PAK e mbulon qendra Pogradec me 1,945 persona ose 44.6%, ndërsa numrin më të ulët e ka njësisia Velçan me 199 ose 4.5%. Nga ky numër total i personave me aftësi të kufizuara, 3.3% janë persona me statusin e personit para/tetraplegjik (n=57), nga të cilët rreth 42% janë femra (n=24). Të gjithë këta persona përfitojnë kujdestarinë. Një tjetër informacion në lidhje me PAK, është një aspekt pozitiv, ai i mbajtjes së të dhënave dhe për komunitetin rom. Nga të gjithë PAK, rreth 3,9% i përkasin këtij komuniteti.

4.3 Fëmijët në risk

4.3.1 Fëmijët me aftësi të kufizuara

Për të planifikuar dhe zbatuar praktika bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve sociale të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara së pari nevojitet informacion i plotë i situatës dhe i rivlerësuar periodikisht. Megjithëse në Pogradec janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të mbledhur informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata që ndjekin shkollat dhe kopshtet publike të bashkisë, për tregues që lidhen me moshën, gjininë, ciklin shkollor dhe llojin e aftësisë së kufizuar, ato sërish janë të pamjaftueshme për të ofruar një pasqyrë të plotë të situatës. Kjo për arsye se treguesve ekzistues u mungojnë ato të lidhur me evidentimin e specifikave që burojnë nga lloji i aftësisë së kufizuar, shërbimeve mbështetëse të nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat, situatës sociale dhe ekonomike të familjeve, etj. Për të rritur cilësinë e informacionit dhe mundësinë për raportime sa më të sakta të situatës si dhe me qëllim sigurimin e mbështetjes për mbarëvajtjen e procesit, nevojitet që pranë Bashkisë (Drejtoria e shërbimeve sociale) të krijohet një sistem i digjitalizuar të dhënash, i ndërtuar me tregues të përgjithshëm dhe specifik për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në Bashkinë e Pogradecit është ngritur dhe funksionon “Qendra Komunitare”, një projekt i Programit të Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri. Ndërhyrja u zhvillua në vazhdim të bashkëpunimit me Bashkinë Pogradec për hartimin e "Planit Lokal të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara". Plani, i hartuar në fillim të vitit 2015, është një instrument që ka për qëllim të udhëheqë Bashkinë Pogradec dhe strukturat e tjera lokale në adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimin për ta të mundësive për përfshirje në komunitet. Përpilimi i këtij dokumenti u parapri nga një seri aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të interesuar në këtë bashki ndërsa vetë dokumenti ishte rezultat i diskutimeve, konsultimeve dhe bashkëpunimit ndërmjet një grupi të gjerë profesionistësh të mbrojtjes sociale, shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe planifikimit të territorit, si dhe i grupeve të interesit në territorin e Pogradecit. Një nga masat e propozuara nga Plani i Veprimit lidhej me ngritjen e një qendre zhvillimi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, “Askush të mos mbetet pas”, po mbështet që prej një viti 48 Persona me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë e Pogradecit. Janë 48 fëmijë dhe të rinj që trajtohen çdo ditë në këtë qendër. Nga këto, 33 fëmijë dhe të rritur vijnë nga zonat urbane,

ndërsa 13 të tjerë nga zonat rurale. 12 fëmijë shkojnë në kopshte dhe shkolla ndërsa marrin edhe shërbimin e qendrës. Në këtë qendër bëhet një punë e specializuar individuale dhe kolektive për personat me aftësi të kufizuara. Në kuadrin e PKS-së është propozuar që Qendra Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Pogradec të zhvendoset në një godinë ekzistuese 2 kate, me sipërfaqe 544 m², dhe të kthehet në Qendër Multifunktionale, në mënyrë që të sigurohet që një numër më i madh personash të marrin shërbime në qendër. Shërbimet kryesore për personat me aftësi të kufizuara ofrohen nga: Fondacioni Nehemia, shkolla Amoro Ton, Qendra Dita e Shpresës.

4.3.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë

Studimi kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri “Nga lypja në rrugë, në udhëne mbrojtjes dhe kujdesit”¹⁰, i financuar nga UNICEF dhe Save the Children në prill 2014, tregoi se numri i fëmijëve në situatë rruge në Qytetin e Pogradecit, në të dy fazat e numërimit ishte 52 fëmijë ose 2.6% e fëmijëve të vrojtuar. Të dhënat e studimit treguan se shumica e fëmijëve në situatë rruge nuk kanë arritur moshën 14 vjeçare, megjithëse kanë pjesë të konsiderueshme të adoleshentëve në situatë rruge të cilët janë të moshës 15-17 vjeç. Për shumicën e tyre përvoja errugës nis rreth fëmijërisë së hershme, gjatë së cilës fëmijët janë në rrugë të shoqëruar nga nënat e tyre gjatë lypjes.

Tabela 11. Informacion lidhur me numrin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge të menaxhuara gjatë vitit 2018

Bashkia Pogradec		Periudha Janar-Dhjetor 2018
	Numri i rasteve të menaxhuara në total	6
	Numri i rasteve të reja për vitin 2018	6
	<i>Sipas Grupmoshës:</i>	
	0-6 vjeç	5
	7-14 vjeç	1
	15-18 vjeç	0
	<i>Sipas Gjinisë :</i>	
	Femra	3
	Meshkuj	3
3	Sipas institucioneve referuese	
	NJMF	6
	Policia	0

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Pogradec

¹⁰ 2014, ARSIS, Studim kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri- “Nga lypja në rrugë, në udhëne mbrojtjes dhe kujdesit”

Nga i njëjtitudim i vitit 2014 doli se ndërmjet fëmijëve në situatë rruge në Pogradec, numri i djemve është shumë më i madh se numrit i vajzave (80.7% djem dhe 19.3% vajza). Pogradeci ka përqindjen më të ulët të vajzave në situatë rruge krahasuar me qytete të tjera. Njëveçori e fëmijëve në situatë rruge në Pogradec është se ata janë kryesisht nga komuniteti i shumicës shqiptare dhe jo ngakomunitetet rome dhe egjiptiane. Nga intervistat e thelluara të këtij studimi, kuptojmë se shpeshësia me e madhe e situatës së fëmijëve në rrugë për lypje ndodh gjatë muajve të verës.

4.4 Të rinjtë me probleme sociale

4.4.1 Papunësia tek të rinjtë

Nuk ka matje dhe vlerësime të dedikuara për treguesit e tregut të punës në Bashkinë e Pogradecit, megjithatë AFP në vitin 2016¹¹ tregoi se shkalla e papunësisë në rajonin e Korçës (përfshin Bashkinë e Pogradecit) ishte përkatësisht 18.6% krahasuar me 15.4% për nivelin kombëtar. Anketa gjithashtu tregoi se të rinjtë në grup-moshat 15-29 vjeç kanë nivele më të larta papunësie (23%) sesa grup-moshat e tjera.

Norma e lartë e papunësisë tek të rinjtë në Pogradec është pasojë e një ekonomie të pamaturuar të qytetit, e cila nuk ka aftësinë të krijojë vende pune në ritme të tilla që t'i përgjigjet gatishmërinë për punë të kësaj grup-moshe. Gjithashtu norma e lartë e papunësisë tek të rinjtë mund të jetë pasojë e mungesës së kualifikimeve kundrejt kërkesës për fuqi punëtore të kualifikuar të tregut. Faktorë të tjerë që ndikojnë në tregun e punës të të rinjve në këtë qytet kanë të bëjnë me dështimet e arsimit dhe politikave si dhe masave të pamjaftueshme ndaj grupeve të veçanta të të rinjve.

Kutia 1.

Gjetje të Studimit¹²

- Shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 27,2 %. Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve pësoi një rënie prej 2.1 pikë përqindje.
- Në vitin 2017, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që nuk janë në punë e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 31,4 % të të rinjve gjithsej. Në këtë grup, 35,0 % e të rinjve janë të papunë.
- Pjesa tjetër janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (9,9 %), duke përbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (22,9 %), ose për arsye të tjera (31 %).
- Duke krahasuar të rinjtë që janë as të punësuar e as në shkollë apo trajnim profesional sipas gjinisë dhe statusit të tyre në tregun e punës, vihet re se meshkujt janë më aktivë në treg sesa femrat (49,7% e meshkujve janë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për të

¹¹ Anketa e Forcave të Punës INSTAT 2016

¹² IPP&NS, 2018 “Vlerësimi i shpejtë i nevojave për formim profesional dhe kërkesës për profesione dhe aftësi të tregut të punës në Pogradec”

punuar, ndërsa tek femrat kjo përqindje është 22,4 %).

4.5 Gratë me probleme sociale

Në Bashkinë Pogradec janë regjistruar në total 92 raste të viktimave të dhunës në familje përgjatë vitit 2018.

Tabela 12. Gratë me probleme sociale dhe dhuna në familje

Gratë me problem sociale	2018
Kryefamiljare të familjeve të varfëra	10
Gra viktimë të dhunës në familje	92
Gra me histori të trafikimit	0

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Pogradec

Prej disa vitesh Bashkia Pogradec ka në planet e saj ngritjen e një qendre emergjence për dhënien e ndihmës së parë për gratë dhe vajzat e dhunuara. Por për shkak të mungesës së mbështetjes financiare kjo gjë nuk është bërë e mundur. Ndërkohë, shoqata lokale “Unë, Gruaja”, një ndër aktorët kryesorë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave në Pogradec, prej vitesh punon në mënyrë të dedikuar për parandalimin, mbrojtjen dhe trajtimin e grave dhe vajzave të dhunuara.

4.6 Familjet e pastreha

Strehimi Social bazuar në ligjet përkatëse, ka marrë një zhvillim të ri në kontekstin vendor. Për të ndihmuar dhe zgjidhur këtë problem për 28 familjet e bashkisë Pogradec, Bashkia në mënyrë afatgjatë, ka aplikuar skemën “për fonde rikonstruksioni” si pjesë e politikave të ndryshme për strehim, duke trajtuar në këtë mënyrë të gjithë familjet me probleme strehimi.

Tabela 13. Familjet e pastreha

Familje:	Viti 2018
Familje me problem të strehimit	28
Aplikuar për kredi të butë	0
Aplikuar për bonusin e qerasë	0
Aplikuar për fonde rikonstruksioni	28
Tjetër	0
Gjithsej	28

Burimi: Bashkia Pogradec

Në perspektive, Bashkia Pogradec do të hartojë planin e strehimit social sipas alternativave, që jep mundësinë ligji aktual për strehim¹³. Për të gjithë alternativat, është e rëndësishme që bashkia të bëjë planifikimin e trojeve, që do të propozohen për strehim. Përcaktimi, planifikimi dhe sigurimi i pronësisë për këto troje është kushti bazë, për të aplikuar për çdo projekt dhe thithje investimesh, në lidhje me strehimin social. Aktualisht, në Bashkinë Pogradec, ka strehim provizor në godina të papërshtatshme për banorët në nevojë.

4.7 Komunitetet

Bashkia ka ngritur struktura përgjegjëse për komunitetet Rom dhe Egjiptian dhe çështjet e lidhura me to, siç janë verifikimin e numrit të familjeve si dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave ekonomike, sociale, të strehimit etj.

Megjithatë nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e familjeve të këtyre komuniteteve. Gjithashtu ka të dhënatë pjesëshe mbi zonat e vendosjes së këtyre komuniteteve në territorin e bashkisë. Për efekt të hartimit të PKS-së, i jemi referuar të dhënave të siguruara nga shoqatat e komunitetit Rom dhe Egjiptian, sipas të cilave rezulton se në Bashkinë Pogradec (qytet) jetojnë 600 familje Egjiptiane dhe 566 familje Rome me rreth 2,825 individë.

Sipas tabelës më poshtë në bashkinë Pogradec familjet R/E jetojnë në qytetin e Pogradecit dhe në fshatrat Buçimas, Çërravë dhe Guras. Në dy zona periferike të qytetit Pogradec, në Guri i Kuq dhe Gurorë banojnë disa familje Rome. Sipas studimit të CESS dhe UNICEF (2013) popullsia Romenë bashkinë e Pogradecit është 1,075 banorë. Ndërsa popullsia Egjiptiane, sipas intervistave të realizuara me përfaqësues të organizatave Egjiptiane, është rreth 600 familje.

Tabela 14. Popullsia R / E në qytetin dhe fshatrat e Bashkisë Pogradec

Njësitë Administrative/ vendbanimet	Rom		Egjiptian	
	Numër	Përqindje	Numër	Përqindje
Pogradec	377	71.7		
Buçimas	0	0		
Guras	0	0		
Gur I kuq	76	14.4		
Çërravë	39	7.4		
Gurorë	34	6.5		
Totali	566	100	600	100

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Pogradec

¹³ Plani i Përgjithshëm Vendor (2016 – 2031) Bashkia Pogradec

Lidhur me problematiken e strehimit, Bashkia ka informacion për kushtet e banimit e këtyre grupeve në situatën e tanishme. Mbështetur në këto të dhëna, Bashkia ka plane për ndërhyrje për përmirësimin e këtyrekushteve si:

- Përmirësim të kushteve të banimit.
- Privatizim të banesave ku ata jetojnë vetëm me autorizime strehimi nga bashkia.

Bashkia ka plane për strehim dhe pajisjen me infrastrukturë në zonat ku banojnë këto komunitete dhe ka ndërmarrë veprime konkrete si:

- Hartimi i projektit për rehabilitimin e zonës së “Gurit të Kuq” për kthimin në një zonë turistike atraktive
- Sistemim rrugësh, blloku “Prroi i Çaprazit”.

Problemet kryesore të strehimit të familjeve Rome dhe Egjiptiane janë:

- Ambientet hidrosanitare
- Infrastruktura rrugore
- Gjendja e keqe e godinave

Bazuar në një vlerësim të bërë në vitin 2016, me iniciative të MZHU-së dhe mbështetur nga PNUD, “Vlerësim i nevojave për investimet vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkitë Elbasan, Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre”¹⁴ rezultoi se problemet më të rëndësishme me të cilat haset familja rome dhe egjiptiane janë si në tabelën me poshtë.

Tabela 15. Problemet më të rëndësishme me të cilat ndeshet familja R / E (në %)

Nr.	Problemet më të rëndësishme	Gjithsej	Rome	Egjiptiane
1	Mungesa e ushqimit	11.3	18.4	7.1
2	Papunësia	45.8	39.5	49.6
3	Kushtet e këqija të banimit	17.3	25	12.6
4	Mungesa e veshmbathjeve	5.9	3.9	7.1
5	Problemet shëndetësore	17.7	11.9	21.3
6	Infrastruktura e keqe (mungesa në ujë të pijshëm, kanalizimet etj.)	0.5	0	0.8
7	Tjetër	1.5	1.3	1.5
	Total	100	100	100

Burimi: Anketa me familjet Rome dhe Egjiptiane, 2016.

¹⁴<https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Vler%C3%ABsimi%20i%20nevojave%20p%C3%ABr%20investime%20n%C3%AB%20vendbanimet%20e%20komuniteteve%20Rome%20dhe%20Egjiptiane%20-%20Elbasan,%20Pogradec,%20Maliq,%20Korce,%20Devoll.pdf>

Niveli i papunësisë së popullsisë R/E është shumë i lartë. Sipas të dhënave të të njëjtës anketë 5.1 % e Romëve dhe 3.7 % e Egjiptianëve punojnë në sektorin formal. Ndërsa 33.7 % e Romëve dhe 33.3% e Egjiptianëve shprehen se punojnë me raste në sektorin informal. Thuajse 61 % e Romëve dhe 63 % e Egjiptianëve në moshë pune (grup-mosha 15 ÷ 64 vjeç) thonë se nuk punojnë. Kjo papunësi është shumë më e lartë tek gjinia femërore (80.8 % tek Romët dhe 92 % tek Egjiptianët) dhe tek të rinjtë e grup-moshës 15 ÷ 30 vjeç (68.7 % tek Romët dhe 74.4 % tek Egjiptianët).

R/E, kanë një kuptim shumëdimensional për varfërinë. Ata e kuptojnë varfërinë në aspektin e pamundësisë për të plotësuar nevojat minimale të jetesës. Nga të gjithë elementët që u renditen në tabelën më sipër, më të rëndësishëm janë nevojat materiale (si ushqimi, veshja, strehimi, etj.). Shkaqet kryesore të varfërisë dhe të përjashtimit social të R/E janë papunësia, të ardhurat e ulta nga puna e pakualifikuar në sektorin informal, mungesa e arsimit, infrastruktura, kushtetë këqija të banimit dhe diskriminimi.

Aktualisht numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike janë 51 familje romë dhe 142 përfitues familje Egjiptiane. Gjithashtu në njësitë administrative Buçimas dhe Proptisht ka një numër të konsiderueshëm familjesh Egjiptiane të cilat janë përfituese të ndihmës ekonomike.

Analiza SWOT Bashkia Pogradec

Pogradeci mund të evidentohet si një nga zonat me potenciale zhvillimi ekonomik dhe social nga më të favorshmet në Shqipëri, për arsye të avantazheve krahasuese të qytetit dhe zonës së bashkisë në tërësi. Shfrytëzimi i këtij potenciali ekonomik në bazë të politikave vendore të qëndrueshme është i rëndësishëm për zhvillimin social, për të mundësuar që të jetë gjithëpërfshirës: shpërndarja e zhvillimit ekonomik është po aq e rëndësishme sa zhvillimi ekonomik, qasja e autoriteteve vendore duhet të jetë e tillë që problemet e grupeve në nevojë të vlerësohen dhe monitorohen në thellësi, me qëllim përfshirjen e këtyre grupeve në zhvillimin ekonomik dhe social të bashkisë.

Nëpërmjet metodologjisë së ndjekur për hartimin e Planit të Përfshirjes Sociale 2018-2022, siguroam zërin e grupeve të interesit në përcaktimin e prioriteteve dhe masave për përfshirjen sociale të tyre, siguroam gjithashtu që këto grupe të kenë vendin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe urban të bashkisë.

Tabela 7. Analiza SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
<ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat demografike të qytetit të Pogradecit me moshë mesatare relativisht e re, 70% e popullsisë në moshë aktive për punë, përbën potencial për zhvillimin e forcave të punës dhe përfshirjen në tregun e 	<ul style="list-style-type: none"> - Niveli i lartë i papunësisë në fusha të veçanta të popullsisë siç janë të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi ndryshe. - Një komunikim dhe lidhje e dobët ndërmjet komunitetit të biznesit dhe

<p>punës të grupeve në rrezik përjashtimi siç janë gratë dhe të rinjtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozicioni gjeografik i favorshëm si pjesë e korridorit VIII dhe pjesë e rrjeteve të zonave natyrore të mbrojtura. - Shtirirja pranë liqenit. - Pogradeci ka potenciale ekonomike dhe burime natyrore të larta krahasuar me qytete të tjera. Zhvillimi i turizmit, dhe i degëve të tjera të ekonomisë specifike, jep mundësi për përfshirjen në tregun e punës të grupeve të veçanta. - Pogradeci është një qytet që ka tërhequr vëmendjen e organizatave ndërkombëtare, duke sjellë projekte dhe praktikrat më të mira të përfshirjes sociale. - Angazhim i pushtetit vendor në Bashkinë e Pogradecit për respektimin e të drejtave të njeriut. - Pasuri të mëdha natyrore, monumente arkeologjike, gjeomonumente, monumente kulturore, historike, dhe natyrore të shumta (Kalaja, Monumentet e Selcës, Bazikila e Linit, Guri i Kamjes, Burimi i Drilonit, Guri i Nikës, Liqenet e Lukovës etj.). 	<p>pushtetit vendor në Pogradec.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë, si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik - Mungesa e infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore dhe mbulesa me shërbime dentare në të gjithë territorin e qytetit, veçanërisht në disa zona, si p.sh. zonat informale, zonat e kontaminuara dhe zonat e thella të qytetit. - Pamundësia e pushtetit vendor për ta strehuar dhe sistemuar këtë pjesë të popullatës. - Një tërheqje e madhe e grupeve të përjashtuara veçanërisht e të rinjve drejt Tiranës. - Politikat sociale lokale deri diku të munguara të Bashkisë së Pogradecit për përfshirjen sociale të grupeve të veçanta siç janë romët, egjiptianët dhe personat me aftësi ndryshe. - Ekonomia informale që ekziston në qytet, nuk i jep shanse grupeve të ndryshme të përfitojnë nga skemat e transfertave siç janë ato të mbrojtjes sociale dhe pensioneve.
<p>MUNDËSITË</p>	<p>RREZIQET</p>
<ul style="list-style-type: none"> - Pogradeci është një qytet me potenciale ekonomike të mëdha. Kryqëzim rrugësh, mundësi të zhvillimit të turizmit, agrobiznesit, të gjitha këto e bëjnë Pogradecin një qytet që nxit zhvillimin e tregut të punës, rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë. - Në qytetin e Pogradecit janë investuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Reforma territoriale dhe zgjerimi i hapësirës territoriale të funksionimit të pushtetit vendor të Bashkisë së Pogradecit, ka bërë që shumë nga problemet sociale ekonomike të popullatës që kanë qenë jashtë territorit të bashkisë, të mos njihen dhe për rrjedhojë të neglizhohen.

nga organizatat e brendshme dhe të huaja (BE dhe UN), njohuri dhe praktika për të rritur cilësinë e shërbimeve në fushën arsimore, shëndetësore dhe mbrojtjes sociale.

- **Ekzistenca e organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit janë mekanizma që i vlejné procesit të përfshirjes sociale dhe angazhimin e grupeve të veçanta në këtë proces.**
- **Disa prej reformave të ndërmarra në vend adresojné grupet e përjashtuara, (reforma kundër informalitetit, reforma e ndihmës ekonomike, reforma e pensioneve, reforma arsimore, etj.)**
- **Reforma territoriale dhe Ligji i ri 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” zgjeron hapësirën e pushtetit vendor për përfshirjen sociale të grupeve të përjashtuara**

- Migrimi i vazhdueshëm dhe regjistrimicivil i popullatës së ardhur rishtazi (20 vitet e fundit)

- Grupet e interesit nuk janë të mirë-organizuar dhe kompakte në prezantimin e problemeve të tyre.

1. Përcaktimi i fushave, qëllimeve dhe objektivave të PKS-së

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi 1. Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec.

Objektivi 1.1: Të ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të standardizuar informacioni mbi nevojat për shërbime dhe ofruesit e shërbimeve.

Aktivitetet:

1. Krijimi i hartës së shërbimeve në territorin e Bashkisë Pogradec dhe krijimi i shportës bazë të shërbimeve shoqërore.
2. Krijimi i hartës së vulnerabilitetit. Një vlerësim i shpejtë i nevojave për shërbime të kujdesit social për të gjitha grupet në risk, në bashkëpunim me organizatat dhe operatorët që veprojnë në territor.
3. Krijimi i një bazë të dhënash për individët/ familjet dhe grupet, përfitues të shërbimeve dhe ndarja e të dhënave me operatorët/organizatat që ofrojnë shërbime në terren. Popullimi me të dhëna i Regjistrisë Elektronike Kombëtare.
4. Vendosja e një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjësepërshërbimet sociale në bashki, NJA, OJF-të, Donatorët, Ministria përkatëse

FUSHA 2 : STRUKTURAT DHE BURIMET NJERZORE

Qëllimi 2. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore të shërbimeve sociale

Objektivi 2.1: Ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e bashkisë Pogradec.

Aktivitetet:

1. Ristrukturimi i zyrës në funksion të nevojave për shërbime sociale në territor.
2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi për strukturën.
3. Ngritja dhe funksionalizimi i NJMF-ve.
4. Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 jurist + 1 punonjës social - për NjMF).
5. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor.
6. Krijimi i strukturës së NVRR në Bashki dhe 7njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime.
7. Hartimi i një formati standard për menaxhimin e rasteve.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat

Objektivi 2.2: Të hartojmë mekanizmat për fuqizimin e strukturave të Bashkisë për vlerësimin e nevojave, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga operatorët që veprojnë në territorin e Bashkisë.

Aktivitetet:

1. Hartimi i planit të punës së funksionimit të NVRR.
2. Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave.
3. Hartimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit.
4. Krijimi dhe administrimi i Fondit Social.
5. Trajnimi i stafit (punonjësve të shërbimeve sociale) të Bashkisë mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria

Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësi Administrative.

Aktivitetet:

1. Trajnime për procedurën që do të ndiqet për funksionimin e NVRR.
2. Trajnime për rritjen profesionale, menaxhimin dhe planifikimin.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË POGRADEC

Qëllimi 3. Përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Pogradecit

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Aktivitetet:

1. Ngritja e një qendre ditore në Bashki për shërbime sociale komunitare.

2. Hartimi i modelit të shërbimit.
3. Funksionimi i qendrës së shërbimeve komunitare.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, ASHDMF, DRSHSSH, NJA

Objektivi 3.2: Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare.

Aktivitetet:

1. Konsulencë ligjore falas për lehtësimin e procedurave për gratë kryefamiljare.
2. Nxitja e grave për përfshirje në programet e punësimit dhe sipërmarrje private.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, OJF, Biznesi

Objektivi 3.3: Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë (të moshuarit e vetmuar).

Aktivitetet:

1. Vlerësimi i nevojave për shërbime për “të moshuarit e vetmuar”.
2. Ngritja e një shërbimi lëvizës për të moshuarit në banesë.
3. Vënia në funksionim e shërbimit.
4. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i qendrës

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, DRSHSSH, NJA, OJF

Objektivi 3.4: Të krijohen shërbime komunitare multifunkionale për komunitetin Egjiptian.

Aktivitetet:

1. Ofrimi i programeve fuqizuese profesionale.
2. Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Egjiptian.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF

Objektivi 3.5: Ofrimi i shërbimeve për fuqizimin e të rinjve

Aktivitetet:

1. Përfshirja e të rinjve në aktivitete vullnetare
2. Ndërmjetësim për trajnime dhe kurseve të formimit profesional për të rinjtë e papunë
3. Shërbime ndërmjetësiminëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve të papunë

4. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për parandalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit nga të rinjtë

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF, Zyra e punës

FUSHA 4: PROGRAMET PARANDALUESE

Qëllimi 4: Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese

Objektivi 4.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara

Aktivitetet:

1. Organizimi i aktivitete edukuese për të rinjtë në shkolla.
2. Program sensibilizues kundër diskriminimit dhe bullizmit.
3. Organizimi i programeve të këshillimit dhe mbështetëse për çiftet e reja.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, MSHMS, DAR, NJA, OJF

Objektivi 4.2: Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet ekzistuese

Aktivitetet:

1. Programe edukuese për fuqizimin e familjes.
2. Hartimi i programit dhe funksionalizimi.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, NJA, OJF

Anekset

Aneksi 1. Plani i veprimit për shërbimet e kujdesit social ne bashkinë Pogradec për periudhën 2019-2023

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE							
Qëllimi 1. Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec							
Aktivitetet	Treguesit	Burimet e të dhënave	Aktoret përgjegjës	Koha	Financimi		
					Kosto e parashikuar ne leke	Burimet e mundshme	
						MFE; BASHKIA; NJA	Donatorët e tjere
Objektivi 1.1: Të ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të standardizuar informacioni mbi nevojat për shërbime dhe ofruesit e shërbimeve							
2. Krijimi i shportës bazë të shërbimeve shoqërore, përfshirëdisa tregues që ndihmojnë popullatën të marrë shërbimin më të përshtatshëm dhe më të arritshëm	Studim për finalizimin e hartës së shërbimeve	DSHS & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, NJA, OJF-të,	2019	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Krijimi i hartës së vulnerabilitetit. <i>(Një studim i nevojave për shërbime të kujdesit social për të gjitha grupet në risk, në bashkëpunim me organizatat dhe operatorët që veprojnë në territor)</i>	Studim			Donatorët, Ministria përkatëse	2019	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion

4. Krijimi i një baze të dhënash për individët/familjet dhe grupet, përfitues të shërbimeve dhe ndarja e të dhënave me operatorët/organizatat që ofrojnë shërbime në terren. Popullimi me të dhëna i Regjistrimit Elektronik Kombëtar	databazë e përfunduar e mirëmbajtur me të dhëna të azhuruara			2019-2020	1,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Vendosija e një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente	linje telefonike e dedikuar në Bashki			2019-2023	90,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					1,990,000		

FUSHA 2: STRUKTURAT DHE BURIMET NJEREZORE

Qëllimi 2. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore të shërbimeve sociale

Aktivitetet	Treguesit	Burimet e të dhënave	Aktoret përgjegjës	Koha	Financimi		
					Kosto e parashikuar në leke	Burimet e mundshme	
						MFE; BASHKIA; NJA	Donatorët e tjerë
Objektivi 2.1: Ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e bashkisë Pogradec							
1. Ristrukturimi i zyrës në funksion të nevojave për shërbime sociale në territor.	zyra funksionale bashkëkohore		Strukturat	2019-2020	10,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi për strukturën	përshkrime pune të finalizuara	DSSH & NJA	përgjegjësepërshërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqata	2019	n/a	n/a	n/a
3. Ngritja dhe funksionalizimi i NJMF-ve	NJMF funksionale ligjërish/institucionalisht		2019	n/a	n/a	n/a	
4. Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 jurist + 1 punonjës social - për NJMF)	staf i rekrutuar		2019-2023	69,120,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë	
5. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor	24 takime		2019-2023	120,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë	
6. Krijimi i strukturës së NVRR në Bashki dhe 7 njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbim	NVRR funksionale ligjërish/institucionalisht		2019	n/a	n/a	n/a	
7. Hartimi i një formati standard për menaxhimin e rasteve	Udhëzues për monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve		2019-2020	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë	

Objektivi 2.2: Të hartojmë mekanizmat për fuqizimin e strukturave të bashkisë për vlerësimin e nevojave, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga operatorët që veprojnë në territorin e bashkisë							
1. Hartimi i planit të punës dhe manual bazë procedurash për funksionimin e NVRR	Plan pune dhe manual bazë procedurash i përfunduar në Dhjetor 2019	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria	2019	300,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave	Metodika përvlerësimin e nevojave			2020	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Hartimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit	Manual i përfunduar			2020	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Krijimi dhe administrimi i fondit social	Fondi social 1% e të ardhurave të bashkisë			2019-2023	42,073,631	Bashkia / MFE	n/a
5. Trajnimi i stafit (punonjësve të shërbimeve sociale) të bashkisë mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016	5 trajnime dy-ditore me pjesëmarrje nga të gjitha NVRR			2019-2023	500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësi Administrative							
1. Trajnime të procedurës që do të ndiqet për funksionimin e NVRR	1 trajnim me pjesëmarrje nga të gjitha NVRR	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e	2019	50,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

2. Trajnime për rritjen profesionale, menaxhimin dhe planifikimin	5 trajnime një-ditore me pjesëmarrje nga të gjitha NVRR		Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria	2019-2023	250,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					123,013,631		

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINE POGRADEC

Qëllimi 3. Shërbimeve sociale të përmirësuara dhe të shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec

Aktivitetet	Treguesit	Burimet e të dhënave	Aktoret përgjegjës	Koha	Financimi		
					Kosto e parashikuara në leke	Burimet e mundshme	
						MFE; BASHKIA; NJA	Donatorët e tjerë
Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve							
1. Ngritja e një qendre ditore në Bashki përshërbime sociale komunitare	1 qendër funksionale në 2019	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjësepërshërbimet sociale në bashki,	2019	n/a	n/a	financim I realizuar nga UNSSIA/PNUD
2. Hartimi i modelit të shërbimit	manual shërbimipër mbrojtjen e fëmijëve		ASHDMF,	2019	300,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

3. Funksionimi i qendrës së shërbimeve komunitare	1 qendër funksionale në 2021		DRSHSSH, NJA		15,300,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3.1. Menaxhimi i rasteve sociale në rrezik (fëmijë + të rinj) në bashkëpunim me aktorët lokale	60 raste të mbuluara përgjatë gjithë kohës			2021-2023	5,400,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3.2. Identifikim dhe rekrutim i familjeve kujdestare dhe trajnimi i tyre	20 familje				100,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3.3. Sensibilizim për çështje që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve, grave të moshuarve, etnitë, PAK	20 aktivitete				400,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3.4. Aktivitetet - kampe verore për fëmijët në nevojë dhe jo vetëm	8 aktivitete				4,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3.5 Veprimtari ditore të qendrës komunitare	qendra funksionale				5,400,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 3.2: Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare							
1. Konsulencë ligjore falas për lehtësimin e procedurave për gratë kryefamiljare	Konsulencë ligjore falas për 216 raste në Bashki e NJV në 5 vitet	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjësepërshërbimet sociale në bashki, OJF, Biznesi	2019-2023	8,640,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

2. Nxitja e grave për përfshirje në programet e punësimit dhe sipërmarrje private	40 projekte propozime të shkruara së bashku me gratë e interesuara			2019-2023	4,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 3.3 Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë (të moshuarit e vetmuar)							
1. Vlerësimi i nevojave për shërbime për “të moshuarit e vetmuar”	Studim / vlerësim nevojash	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjësepërshërbimet sociale në bashki, DRSHSSH, NJA, OJF	2019	n/a	n/a	n/a
2. Ngritja e një shërbimi lëvizës për të moshuarit në banesë.	Shërbim lëvizës funksional			2019-2023	n/a	n/a	n/a
3. Vënia në funksionim e shërbimit për moshën e tretë	Shërbim i ofruar për 216 raste në Bashki e NJV në 5 vitet			2019-2023	2,160,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i qendrës	<i>1 qendër funksionale në 2021</i>			2019-2023	31,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
<i>4.1. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e një Qendre ditore për të moshuarit ne Bashki</i>				2019-2021	19,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

4.2. Vënia në funksionim e shërbimit për moshën e tretë, fillimi i veprimtarisë së seksionit të të moshuarve në qendër				2022-2023	12,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 3.4: Të krijohen shërbime komunitare multifunksionale për komunitetin Egjiptian							
1. Ofrimi i programeve fuqizuese të formimit profesional.	implementim ë programeve të ndryshme për 100 të rinj të komunitetit	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF	2020-2023	6,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Egjiptian.	100 të punësuar nga komuniteti deri në 2022			2020-2021	n/a	n/a	n/a
Objektivi 3.5 Ofrimi i shërbimeve për fuqizimin e të rinjve							
1. Përfshirja e të rinjve në aktivitete vullnetare	Aktivitete vullnetarizmi organizuar nga klubet rinore	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki,, DRFP, NJA, ZRP, OJF, Zyra e punës	2019-2023	4,050,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Ndërmjetësim për trajnime dhe kurse të formimit profesional për të rinjtë e papunë	100 të rinj përfundojnë kurse profesionale			2019-2023	6,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Shërbime ndërmjetësimi nëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve të papunë	marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë/NJA me zyrën e punës			2019-2023	n/a	n/a	n/a

4. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për parandalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit nga të rinjtë	një fushatë ndërgjegjësuere e realizuar çdo vit në çdo shkollë të ciklit të ulët dhe të mesme			2019-2023	2,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					80,450,000		

FUSHA 4: PROGRAMET PARANDALUESE

Qëllimi 4. Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese

Aktivitetet	Treguesit	Burimet e të dhënave	Aktoret përgjegjës	Koha	Financimi		
					Kosto e parashikuar ne leke	Burimet e mundshme	
						MFE; BASHKIA; NJA	Donatorët e tjerë
Objektivi 4.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara							
1. Organizimi i aktivitete edukuese për të rinjtë në shkolla.	10 fushata dhe 20 aktivitete	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, MSHMS, DAR, NJA, OJF	2019-2023	1,100,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Program sensibilizues kundër diskriminimit	10 fushata dhe 20 aktivitete			2019-2023	1,100,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

3. Programe këshillimi dhe mbështetëse për çiftet e reja.	50 takime ndërgjegjësuese për çiftet e reja në 5 NJV			2019-2023	500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 4.2: Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet ekzistuese							
1. Programe edukuese për fuqizimin e familjes	manual	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, NJA, OJF	2020	200,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Hartimi dhe vënia në funksion e programit	50 takime ndërgjegjësuese për çiftet e reja në 5 NJV			2020-2023	500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					3,400,000		

Aneksi 2. Plani i monitorimit dhe vlerësimit

Plani i Shërbimeve Sociale i Bashkisë Pogradecit është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitetet e targetuara në territorin e bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015-2020) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020). Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë. Përgjegjëse për monitorimin e zbatimin e Planit të Shërbimeve Sociale do të jetë Drejtoria e Shërbimeve Sociale me sektorët përkatës, të cilët mbledhin të dhënat dhe identifikojnë boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore.

Plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumenteve të standardizuara të raportimit si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të. Të dhënat administrative do të përdoren nga pjesa më e madhe e institucioneve vendore për të monitoruar pjesëmarrjen e grupeve në nevojë në programet e përgjithshme dhe të synuara të bashkisë, siç janë shërbimet sociale, programet e ndihmës ekonomike, programet e strehimit, programet e punësimit, programet parandaluese, etj. Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Shërbimeve Sociale do të kushtohet ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të grupeve të targetuara.

Bashkia e Pogradecit ka një rol koordinues në zbatimin dhe monitorimin e Planit të Shërbimeve Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Gjithashtu bashkia do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha Njësitë Administrative, OJF-të dhe aktorët e tjerë vendor e rajonal të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të saj. Bashkia do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat adresojnë çështjet e grupeve në nevojë përmes programeve të tyre.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në mes të afatit, në periudhën 2018-2022.
- Pas vlerësimit formues të progresit, bashkia do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të Planit të Shërbimeve Sociale për grupet e targetuara, duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2022.
- Një vlerësim përfundimtar që do të bëhet në fund të 2022, ku do të përcaktohet çdo çështje e pazgjidhur dhe zhvillime që mbeten për t'u realizuar.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave Planit të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Pogradecit 2018-2022 do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në plan;
- rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat (kihen parasysh këtu rreziqet) dhe eksperiencat e mëparshme;
- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritit të politikave dhe masave të Shërbimeve Sociale në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit të Shërbimeve Sociale 2018-2022, do të jetë lista e treguesve të monitorimit e paraqitur për secilin objektiv dhe aktivitet në Planin e Veprimit.

Mënyra e raportimit dhe konsultimit

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Shërbimeve Sociale do të jetë Raporti Vjetor i Shërbimeve Sociale, i përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Pogradecit. Raporti do të hartohet dhe miratohet brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës të vitit të monitoruar. Ky raport do të:

- Vlerësojë Planit të Shërbimeve Sociale me fokus progresin e arritur në përmbushjen e masave dhe veprimtarive nga njëra anë dhe e treguesve të monitorimit nga ana tjetër;
- Identifikojë çështje të reja apo ato ndërvepruese, të cilat mund të trajtohen përmes një qasjeje më të koordinuar;
- Raportoje mbi pikëpamjet/këndvështrimet e aktorëve në nivel rajonal dhe lokal.

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e Planit të Veprimit.

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me grupet në nevojë, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. OJF-të që punojnë për përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë dhe ofrojnë shërbime direkte për ta janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për realizimin e objektivave të Planit të Shërbimeve Sociale. Gjatë periudhës në vijim, bashkia do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, plotësimin e nevojave për strehim të sigurt, punësim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera. Komuniteti ndërkombëtar do të kontribuojë gjithashtu në zbatimin e Planit të Shërbimeve Sociale duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe Rajoni, si dhe duke bashkëfinancuar disa prej aktiviteteve. Për të lehtësuar këtë proces, bashkia ka identifikuar aktivitete specifike të Planit të Shërbimeve Sociale që do të përmirësonin situatën e grupeve dhe komuniteteve në nevojë në territorin e Pogradecit.

Aneksi 3. Kostimi dhe hendeku buxhetor

Shënime të përgjithshme

Plani Kujdesit Social për Bashkinë Pogradec fokusohet në 4 fusha kryesore:

- 1) Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve;
- 2) Strukturat dhe burimet njerëzore
- 3) Shërbimet sociale në bashki
- 4) Programet parandaluese

Plani i Kujdesit Social për Bashkinë Pogradec është dizenuar mbi bazën e 4 qëllimeve kryesore që do të arrihen nëpërmjet realizimit të 11 objektivave që do të bëhen të mundura nëpërmjet implementimit të rreth 38 aktiviteteve specifike, të cilat do të kontribuojnë në arritjen e synimeve prioritare. Plani Veprimit do të zbatohet në periudhën 2019-2023.

Buxhetimi është hartuar mbi bazë programi, i cili përmban të gjithë kostot e lidhura me një fushë të politikës (p.sh. Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve). Buxhetimi mbi bazë programi nënkupton fillimisht përcaktimin e politikave e më tej mbi këtë qasje politikepërcaktohen qëllimet /objektivat /produktet /aktivitetet

Objektivat e Politikës janë arritje specifike të politikës, saktësisht të matshme në kohë, numër dhe kosto, që mund të arrihen gjatë periudhës dhe që janë hapa të ndërmjetme drejt arritjes së Qëllimit të Politikës. Të gjitha shpenzimet e programit duhet të kontribuojnë në përmbushjen e Objektivave të deklaruar. Objektivat duhet të jenë të pavarura nga njëra-tjetra në mënyrë që të maten veçmas pa krijuar mbivendosje apo vlerësim të dyfishtë.

Kostimi i aktiviteteve është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar *shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte (investimet)* dhe *ato jashtë projekteve (paga, sigurime dhe shpenzimet operative)*. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në RSH sikurse parashihet në ligjin organik të buxhetit dhe në udhëzimet përkatëse MF.

Shembull kostimi:

Objektivi 1




Produkti B



Aktiviteti B 1

Pema e Programit është një mënyrë skematike për të përshkruar punën e planifikuar të një Programit. Pema tregon se si burimet e shpërndara në detyra individuale (Aktivitete) eventualisht do të çojnë në realizimin e ambicieve afatgjata të politikës (Qëllimeve). Shuma totale e burimeve të shpërndara në Aktivitete do të barazojë shpenzimet totale të buxhetuara të Programit. Ose, e parë nga një këndvështrim tjetër, do të tregojë se si ambiciet afatgjata të politikës (Qëllimi) konvertohen në një set konkret detyrash (Aktivitete) të cilat do të kryen vit pas viti që do të rezultojnë në Produkte dhe të cilat mund të maten dhe monitorohen me qëllim që të sigurojnë që politika e synuar është zbatuar

PEMA E PROGRAMIT



Qëllimi i kostimit ishte përcaktimi i shpenzimeve të detajuara për të gjitha aktivitetet e planit të veprimit bazuar në analizën dhe informacionin e marrë nga institucionet përgjegjëse, kryesisht BashkisëPogradeç.

Objektivat specifik të procesit të kostimit janë:

- (i) kostimi realist i të gjitha aktiviteteve;
- (ii) analiza e detajuar e burimeve buxhetore të brendshme institucionale dhe
- (iii) analiza e detajuar e burimeve të jashtme në dispozicion.

Përmbledhje e kostos së Planit të Veprimit

PERSHKRIM Objektiv Strategjik(OST) Objektiv Specifik(OSP) ACTIVITETI (A)	KOSTO TOTALE					FINANCUAR NGA				Kosto te pambuluara Euro
	V2019	V2020	V2021	V2022	TOTALI	Bashkia	Donatoret	Te tjere	Totali	
OST 1:										
OSP1.1	500,000				500,000	200,000	300,000	0	500,000	0
OSP1.1										
OSP1.1										
Totali-OST 1 neALL	500,000	0	0	0	500,000	200,000	300,000	0	500,000	0
Totali-OST 1 neALL										
TOTALI-PLANI VEPRIMIT ne Euro	500,000	0	0	0	500,000	200,000	300,000	0	500,000	0
Objektiva Strategjik/Objektiva Specifik	Totali	Si% brenda outcome-it		Si% ndaj totalit	Kosto te pambuluara ne Euro	Kosto te pambuluara ne % ndaj totalit per secilin output/outcome				
OST 1:										
OSP1.1:	500,000	100.0%		100.0%	0	0.0%				
OSP1.2:	0	0.0%		0.0%	0	#DIV/0!				
OSP1.3:	0	0.0%		0.0%	0	#DIV/0!				
Totali-OS 1	500,000	100.0%		100.0%	0	0.0%				
Totali-OS 2										
Totali-OS 3										
Totali-Plani Veprimit	#REF!			#REF!	#REF!	#REF!				

Shënim: Kjo tabelë mund të plotësohet me informacion në momentin që përcaktohet qartë angazhimi i Bashkisë për financimin e këtij plani veprimi.

Rezultatet kryesore dhe konkluzionet nga procesi i kostimit

Procesi i kostimit kërkoi një angazhim dhe kohë të dedikuar. Për çdo objektiv/rezultat/aktivitet u bë një analizë e detajuar për të përcaktuar qartë njësinë, sasinë, koston/njësi dhe koston totale për çdo aktivitet.

Një plan i mirë buxhetormundëson:

- Një deklaratë gjithë përfshirëse të Bashkisë që të shndërrojë politikat e veta për Shërbimin Social në veprime konkrete nëpërmjet buxhetimit të shërbimeve.
- Një plan të detajuar pune për këdo që punon në departamentin e Shërbimeve Sociale në Bashki.
- Që arritet të mund të krahasohen me planin.

Konkluzionet nga procesi i kostimit:

- Kostot e përgjithshme vjetore për zbatimin e PKS kanë një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2019-2023.
- Nga llogaritjet rezulton që buxheti i Bashkisë me burimet nga të ardhurat totale në dispozicion për 4.5 vite mund të mbulojë kostot e përgjithshme për zbatimin e planit të veprimit 2019-2023. pa konsideruar në këtë buxhetim koston e pagave të personelit aktual, shpenzime rutinë të personelit të shërbimeve sociale si dhe pagesat mujore të ndihmës për NE dhe PAK, por vetëm ndërhyrjet përmirësuese të parashikuara në këtë plan aktivitetesh. Gjithsesi nga ky kostoim shikohet që Bashkia do të duhej të shpenzonte 5% të buxhetit total

dhe të heqë dorë nga shpenzime të tjera që i përgjigjen politikave të bashkisë dhe që mund të jenë njësoj apo është më tepër prioritarë për të. Një situatë realiste, bashkia nuk do të mbulonte 100% këto kosto, ndaj ndërhyrja me fonde e donatorëve të ndryshëm është e domosdoshme,

- Shpenzimet më të mëdha nevojiten për arritjen e objektivave të fushës 2 (59% e kostove të përgjithshme) pasuar nga fusha 3 (39%), fusha 4 (1.6%) dhe fusha 1 (1%). Vlen të theksohet se shpenzimet mujor për ndihmën e shtetit si detyrim ligjor për PAK dhe NE nuk janë të përfshira në këtë plan.

Rekomandime për Buxhetimin e PKS Bashkisë Pogradec

Konkluzionet e mësipërme nxjerrin nevojën e marrjes së masave që do të çonin në gjetjen e burimeve alternative të financimit, për aktivitetet që nuk mund të mbulohen nga buxheti i Bashkisë

- Procesi i kostimit dhe konkluzionet e mësipërme mund të përdoren nga Bashkia dhe institucione të tjera përgjegjëse për zbatimin e PKS si një dokument për të negociuar me donatorë potencial.
- Fondet e angazhuara nga donatorët për zbatimin e PKS janë të panjohura saktësisht. Stafit i Bashkisë duhet të angazhohet në shkëmbim projektsh dhe thithje fondesh nga donatorë të ndryshëm për mbulimin e 100% të shpenzimeve të parashikuara në këtë plan buxhetor
- Dokumenti mund të përdoret nga Bashkia Pogradec si një mjet për të argumentuar kërkesat e tyre për fonde gjatë miratimit të projekt buxhetit vjetor në Këshillin Bashkiak, për periudhën 2020-2023.
- Në Bashkinë Pogradec duhet të rriten kapacitetet e stafit për të hartuar projekt propozime në funksion të zbatimit të PKS, në mënyrë që të mundësojnë ngritjen e fondeve.
- Duhet të koordinohet në vazhdimësi marrja e informacionit nga agjenci të ndryshme donatore dhe aktorë lokal në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i përdorimit të fondeve që janë në dispozicion dhe të shmangen mbivendosjet e panevojshme.

Aneksi 4. Shporta e shërbimeveshoqërore

	Shërbime që ofrohen në Bashki	Shërbime që nuk ofrohen në Bashki
A - Shërbime parashoqërore:		
	informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme,	këshillimi on-line;
b) Shërbime në komunitet:		
Shërbimi në Familje	Nuk ka	<ul style="list-style-type: none"> i. shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rastit; ii. shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi; iii. dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit; iv. mbajtjen e higjienës personale; v. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti.
Shërbimi përkujdesjes alternative	i Nuk ka	<ul style="list-style-type: none"> i. fëmijë pa kujdes prindëror; ii. fëmijë të privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi familjar.
Shërbimi multifunksional	<ul style="list-style-type: none"> i. shërbime për rehabilitimin fizik dhe psikosocial; ii. këshillime për punësimin, edukimin shëndetësor, arsimim, argëtim; 	<ul style="list-style-type: none"> i. këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, ii. fuqizimin e individit/ familjes;
Qendrat ditore	<ul style="list-style-type: none"> i. personat me aftësi të kufizuara - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor; 	<ul style="list-style-type: none"> i. fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike – Shërbimet për këtë kategori përfshijnë shërbime për higjienë personale, ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje, psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin; ii. të moshuarit - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim.
Shërbimi emergjencës 72 orë	<ul style="list-style-type: none"> i. viktima të dhunës në familje dhe fëmijët; ii. fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara; 	<ul style="list-style-type: none"> i. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.
Shërbimi për të pastrehët	Banesa sociale	<ul style="list-style-type: none"> i. strehim gjatë natës; ii. mensë; iii. mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe riintegrim sa më të shpejtë
Shërbimi strehimit të mbrojtur	<ul style="list-style-type: none"> i strehim, siguri fizike, ushqim, kujdes shëndetësor, trajtim psikologjik dhe emocional, këshillim dhe referim të shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese në tregun e punës për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre; 	<ul style="list-style-type: none"> i. mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit, terapi rehabilituese, këshillim dhe mbështetje për integrim në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara.
c) Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.		
Shërbimet afatgjata rezidenciale	Vetëm në nivel kombëtar	Shërbime rezidenciale për të moshuarit, nenat – vajza, gratë e dhunara, gratë e trafikuar, të alkoolizuar dhe përdorues droge, personat me aftësi të kufizuara. Këto shërbime ofrojnë qëndrim, akomodim, ushqim, arsim, kulturim, shërbime shëndetësor, këshillim ligjor, psikologjik dhe social.

